



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 30.5.2023

RAPORT MONITORIMI  
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

(Janar – Prill 2023)

Detajimi i buxhetit për vitin 2023 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë shtator 2021. Detajimi i fondeve për vitin 2023 është realizuar sipas gjashtë programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysht objektivat, qëllimi i synuar për vitin 2023, përfituesit, në objektivat të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2023, strategjinë e arsimit parauniversitar, si dhe kërkesave për implementimin e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Për vitin 2023, **Ministria e Arsimit dhe Sportit** ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore sipas gjashtë programeve arsimore, të listuar me poshtë:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Lartë”
5. Programi “Kërkimi shkencor”.
6. Programi “Për Zhvillimin e Sportit”.

**Fondet e miratuara me ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”** për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023, janë në shumën prej **47 miliard e 174 milion lekë**, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin për vitin 2023 arrijnë në **6.8%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2023 janë në nivelin **2.2%**.

Tabela nr. 1\_ **Fondet e miratuara me ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”**, në 000 lekë.

Fondeve Buxhetore te miratuara per vitin 2023, me ligjin e nr. 84/2022 "Per buxhetin e vitit 2023", (ne 000/LEK)									
Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Sturktuara ne % e fondeve 2023,	Ndryshimi ne 000 lekë fondeve 2023, ndaj vitin 2022	Ndryshimi ne % fondeve 2023, ndaj vitin 2022
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale				
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	42,620,000	3,934,000	620,000	4,554,000	47,174,000	100.0%	1,336,718	2.9%
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	740,879	55,000		55,000	795,879	1.7%	20,732	2.7%
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	23,853,434	1,437,000		1,437,000	25,290,434	53.6%	131,953	-0.5%
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	6,868,687	1,162,000		1,162,000	8,030,687	17.0%	435,215	5.7%
09450	Arsimi Universitar	10,400,000	880,000	300,000	1,180,000	11,580,000	24.5%	1,088,205	10.4%
09770	Fonde per Shkencen	481,000	250,000	300,000	550,000	1,031,000	2.2%	263,090	34.3%
08140	“Per Zhvillimin e Sportit”	276,000	150,000	20,000	170,000	446,000	0.9%	338,571	-43.2%

**Fondet e buxhetit të rishikuar për vitin 2023, shtuar me fondet grant të trashëguara nga viti 2022, arrijnë në shumën prej 48 miliard e 875.8 milion lekë**, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2023 në **7.00% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2023 janë në nivelin 2.25%**,

Realizimi për periudhën 4-mujore 2023 është në shumën prej **14 miliard e 163.2 milion lekë**, ose në masën 91% e fondeve të planifikuara për 4-mujorin 2023. (tabela 1.2 sa vijon)

Tabela nr. 1.2 Fondet e buxhetit miratuar me ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, shtuar fondet grant te trasheguara si dhe sipas programeve buxhetore ne 000 Leke;

Nr	Emri i programit	Buxheti Realizuar 12-M 2021	Buxheti Realizuar 12-M 2022	PBA 2023	Buxheti Mirat 2023	Buxheti rishikuar + fonde grant te trasheguara 2023	Buxheti I rishik+ Gante te trasheguar per 4_M 2023	Buxheti realiz 4_M 2023 Grante te trasheguara	Struktura e fondeve per 4-mujorin 2023	Struktura e fondeve te realizuar 4_M 2023+Te ardhurat ne %, ndaj totalit
		Ne milion /lekë	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne %
1	Planif. menaxhim administrim	724.4	728.8	763.7	795.9	797.7	264.1	237.0	90%	1.7%
2	Arsimi baze	23,727.1	25,207.5	23,812.0	25,290.4	25,331.4	8,448.1	8,135.5	96%	57.4%
3	Arsimi i mesem pergjith	6,791.4	7,439.2	7,702.0	8,030.7	8,043.2	2,616.2	2,307.8	88%	16.3%
4	Arsimi profesional	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		0.0%
5	Arsimi i larte	9,188.8	9,356.0	11,330.0	11,580.0	13,118.9	3,912.5	3,309.3	85%	23.4%
6	Kerkimi shkencor	388.6	623.7	931.0	1,031.0	1,138.4	132.5	93.5	71%	0.7%
7	Zhvillim i Sportit	1,085.7	755.0	446.0	446.0	446.1	118.9	80.2	67%	0.6%
	<b>Totali</b>	<b>41,906.0</b>	<b>44,110.2</b>	<b>44,984.7</b>	<b>47,174.0</b>	<b>48,875.8</b>	<b>15,492.3</b>	<b>14,163.2</b>	<b>91%</b>	<b>100.0%</b>

Fondet e rishikuar të buxhetit përfshirë fondet miratuara me ligjin vjetor ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, shtuar dhe fondet grant të trashëguara nga viti 2022, shtuar të ardhurat dytësore të IAL publike të autorizuara ne vitin 2023, arrijnë në shumën prej 49 miliard e 823 milion lekë, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2023 në 7.14% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2022 janë në nivelin 2.29%, së bashku me shtesat e fondeve të rimara/trashëguara nga vitit 2022 nga IAL publike.

Realizimi i fondeve për periudhën 4-mujore 2023 është në shumën prej 14 miliard e 667 milion lekë, ose në masën 89% e fondeve të parashikuara për 4-mujorin 2023.

Tabela nr. 1.3 Fondet e buxhetit miratuar me ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, rishikuar me aktin Normative, si dhe VKM nr. se bashku me te ardhura , si dhe sipas programeve buxhetore ne 000 Leke;

Fondet e buxheti 2023 së bashku me Te ardhurat 4 M parë 2023										
Nr	Emri i programit	Buxheti Realizuar 12-M 2021+Te ardhurat	Buxheti Realizuar 12-M 2022+Te ardhurat	PBA 2023	Buxheti Mirat 2023	Buxheti rishikuar + fondet grant te trasheguara + Te Ardhurat 2023	Buxheti I rishik+ Te ardhurat per 4-M 2023	Buxheti realiz 4-M 2023+Te ardhurat	Struktura e fondeve per 4-mujorin 2023+Te ardhurat	Struktura e fondeve te realizuar 4_M 2023+Te ardhurat ne %, ndaj totalit
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne %
1	Planif. menaxhim administrim	727.9	729.7	763.7	795.9	797.7	264.1	237.0	90%	1.6%
2	Arsimi baze	23,774.3	25,259.1	23,812.0	25,290.4	25,357.5	8,474.1	8,161.5	96%	55.6%
3	Arsimi i mesem pergjith	6,791.6	7,439.7	7,702.0	8,030.7	8,043.3	2,616.3	2,307.9	88%	15.7%
4	Arsimi profesional	0.0			0.0	0.0	0.0	0.0		0.0%
5	Arsimi i larte	11,747.1	12,257.2	11,330.0	11,580.0	14,014.7	4,808.4	3,769.4	78%	25.7%
6	Kerkimi shkencor	442.0	980.4	931.0	1,031.0	1,160.2	154.3	107.5	70%	0.7%
7	Zhvillim i Sportit	1,100.2	760.9	446.0	446.0	449.6	122.5	83.7	68%	0.6%
	<b>Totali</b>	<b>44,583.1</b>	<b>47,427.0</b>	<b>44,984.7</b>	<b>47,174.0</b>	<b>49,823.0</b>	<b>16,439.6</b>	<b>14,667.0</b>	<b>89%</b>	<b>100.0%</b>

Tab\_2 Fondet buxhetore sipas grup artikujve të realizuara për vitin 2021-2022, fondet e miratuara me ligjin vjetor për vitin 2023, plani i rishikuar + të ardhurat dytesore për 12 mujorin 2023, si dhe realizimi sipas artikujve buxhetore faktik për 4 mujorin 2023 në mijë

Kodi	Emri	Buxheti REALIZUAR 12-M 2021+Te ardhurat	Buxheti Realizuar 12-M 2022+Te ardhurat	PBA 2023	Buxheti Mirat 2023	Buxheti rishikuar + fonde grant te trasheguara 2023	Buxheti I rishik+ Gante te trasheguar per 4_M 2023	Buxheti realiz 4_M 2023 Grante te trasheguara	Struktura e fondeve per 4-mujorin 2023	Struktura e fondeve te realizuar 4_M 2023+Te ardhurat ne %, ndaj totalit
		ne 000 lekë	ne 000 lekë	ne 000 lekë	ne 000 lekë	ne 000 lekë	ne 000 lekë	ne 000 lekë	ne 000 lekë	Ne %
600-601	Paga+Sigurime Shoqërore	35,364,995	35,681,707	26,889,939	28,829,939	37,524,651.4	13,159,122.4	12,448,247	88%	95%
602-606	Mallra & Shërbim të Tjera	5,449,417	6,204,419	13,340,781	13,790,061	6,797,102.8	1,693,681.9	1,361,129	10%	80%
230-231	Kapitale Trupez Patrupëz	1,091,608	2,224,099	4,754,000	4,554,000	4,554,000.0	639,540.0	353,832	2%	55%
<b>Totali kap 01-05</b>	<b>Korente dhe Kapitale</b>	<b>41,906,020</b>	<b>44,110,225</b>	<b>44,984,720</b>	<b>47,174,000</b>	<b>48,875,754.2</b>	<b>15,492,344.3</b>	<b>14,163,208</b>	<b>100%</b>	<b>91%</b>
600-601	Shpenzime personeli ne %		84.4%	80.9%	59.8%	61.1%	76.8%	84.9%	87.9%	87.9%
602-606	Mallra Shërbime të Tjera ne %		13.0%	14.1%	29.7%	29.2%	13.9%	10.9%	9.6%	9.6%

230-231	Kapitale Trupez Patrur %	2.6%	5.0%	10.6%	9.7%	9.3%	4.1%	2.5%	2.5%	
600-601 kap 06	Paga+Sigurime Shoqërore	716,003.3	716,003.3		0.0	87,891.3	87,891.3	87,891.3	17.2%	100%
602-606 kap 06	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,240,258.7	1,240,258.7		0.0	308,256.9	308,256.9	214,668.5	42.0%	70%
230-231 kap 06	Kapitale të Trupez Patrurëz	720,780.6	720,780.6		0.0	551,142.8	551,142.8	209,031.9	40.9%	38%
	<b>TOTAL 06</b>	<b>2,677,042.7</b>	<b>2,677,042.7</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>947,291.0</b>	<b>947,291.0</b>	<b>511,591.7</b>	<b>100%</b>	<b>54%</b>
600-601 (kap01-08)	Paga+Sigurime Shoqërore	36,080,998	36,397,711	26,889,939	28,829,939	37,612,543	13,247,014	12,536,138	85.4%	95%
602-606 (kap 01-08)	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6,689,676	7,444,677	13,340,781	13,790,061	7,105,360	2,001,939	1,575,797	10.7%	79%
230-231 (kap 01-08)	Kapitale Trupez Patrur	1,812,389	2,944,880	4,754,000	4,554,000	5,105,143	1,190,683	562,864	3.8%	47%
<b>Totali (2)</b>		<b>44,583,063</b>	<b>46,787,268</b>	<b>44,984,720</b>	<b>47,174,000</b>	<b>49,823,045</b>	<b>16,439,635</b>	<b>14,674,800</b>	<b>100.0 %</b>	<b>89%</b>
600-601	Shpenzime personeli ne %	80.9%	77.8%	59.8%	61.1%	75.5%	80.6%	85.4%		
602-606	Mallra Shërbime të Tjera ne %	15.0%	15.9%	29.7%	29.2%	14.3%	12.2%	10.7%		
230-231	Kapitale Trupez Patrur %	4.1%	6.3%	10.6%	9.7%	10.2%	7.2%	3.8%		

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, konfirmuar nga sistemi SIFQ i Ministrise se Financës.

### Rezultatet që synohet të arrihen për vitin 2023;

- Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor në masën 86%, ndjekja e arsimit bazë e grupmoshës 6-16 vjeç në masën 100%, si dhe përfshirja me përparësi e grupeve vulnerable. Rritja e treguesit të regjistrimit të fëmijëve për nxënësit romë dhe egjiptianë si dhe për nxënësit me AK.
- Reformimi i arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, përmes miratimit të kornizës së re curriculare dhe programeve për çdo grupmoshe për arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, trajnimit të përvitshëm të mësuesve/edukatorëve dhe punonjësve të shërbimit psiko-social (150 psikologë dhe 150 punonjës social) dhe pajisjes me materiale didaktike të kopshteve dhe shkollave.
- Zbatimi/implementimi i kurrikulës së re (klasa 1-5 dhe klasa 6-9) përgatitja e programeve kualifikuese, moduleve dhe testet trajnuese për kurikulën e re. Trajnimi çdo vit i afro 9-12 mijë mësuesve të klasës 1-9 (trajnimi 25% i mësuesve të AB) për kurikulën e re, përfshirë edhe 40 mësues të pakicave kombëtare, si dhe 600-800 mësues ndihmës për fëmijët me AK. Trajnimi i 80-100 mësuesve të diasporës në seminarin mbarëkombëtar për mësuesit e diasporës.
- **Zhvillimi i reformës së teksteve shkollore**, përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së teksteve shkollore si dhe kompensimi i çmimit të teksteve shkollore për klasat I-IX. Qysh në vitin shkollor 2021-2022, janë përfshirë në skemën e ofrimit në përdorim falas edhe nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë, në total llogariten rreth 240 mijë nxënës të arsimit bazë dhe rreth 16-18 mijë nxënës nga kategoritë e veçanta në arsimin e mesëm të lartë, të cilët përfitojnë tekste falas, duke lehtësuar ndjeshëm barrën financiare të familjeve. (Plani i Qeverisë 2021-2025 \_Objektivat për arsimin). **Kompensimi financiar apo dhënia e teksteve shkollore falas**, për nxënësit të arsimit të mesëm të lartë, në masën 100 % të nxënësve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, nxënësve që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, nxënësve që gëzojnë statusin e të verbrit, atyre nga pakicat kombëtare, nxënësit romë, egjiptianë, fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, fëmijët që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie; fëmijë të familjeve që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuar, fëmijë që vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura; familje në nevojë, viktimave të trafikimit.
- **Garantimi i transportit për afro 35-38 mijë nxënësve dhe fëmijë**, që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin bazë që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe 12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës, duke përballuar 100% shpenzimet e transportit me fondet e buxhetit të shtetit.
- **Numri i nxënësve që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë synohet të arrijë 95-98%** e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, nga të cilët 76% ndjekin AM gjimnaze dhe 24% në arsimin profesional.

- **Klasat e profilizuara sportive- do të rritet numri i klasave të profilizuara sportive në mënyrë progresive në të gjithë vendin, nismë e cila ka filluar në vitin shkollor 2021-2022, nga 223 në 423 klasa sportive, duke shtuar edhe disiplina të reja sportive, si gjimnastikë, atletikë dhe tenis. ( *Plani i Qeverisë 2021-2025 \_Objektivat për arsimin*)**
- **Realizimi i Maturës Shtetërore 2023**, sipas kurikulës së re me bazë kompetencën për 30 mijë nxënës që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë. Përmirësimi i rezultateve në provimet e maturës shtetërore duke rritura notën mesatare nga 7.2 aktualisht në 7.5 në vitin 2023-2024.
- **Rritja e cilësisë së mësimdhënies në Arsimin e Lartë**, nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik, me 5% deri 10% në vit dhe rritjes së numrit të stafit akademik me kohë të plotë, duke synuar uljen e raportit mesatar akademik, pedagog me kohë sipas standarteve të Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë.
- **Garantimi i aksesit në bazë të meritës dhe rritja e dimensionit social në arsimin e lartë** duke mbështetur me bursë financiare nxënësit që ndjekin studimet në arsimin e lartë nga kategoritë sociale në nevojë, në masën 18% - 20% të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë dhe në përputhje edhe me parimet e barazisë gjinore;
- **Nxitja e punës kërkimore në IAL publike**, nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3500 -4000 kërkuesve, ku prioritet kane femrat në përputhje me parimet e barazisë gjinore, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit;
- **Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë** – vijojmë punën për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MAS do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.( *Plani i Qeverisë 2021-2025 \_Objektivat për arsimin*);
- **Rritja e aplikimeve në programin “Horizon Europe”**, program për Kërkimin dhe Inovacionin 2021-2027. Programi kuadër “Horizon Evropë” do të bashkojë kërkimin me inovacionin dhe do të ketë një akses më të thjeshtë se programet paraardhëse për kompanitë dhe universitetet.
- **Akreditimi çdo vit i 90-100 programeve të studimit** (ose 10% e programeve të studimit të miratuar aktualisht) në IAL publike dhe private, me synim që të akreditohen 100% të programeve brenda vitit 2030;
- **Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat përmes Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit**, duke organizuar edhe seminare dhe takime informuese në IAL si dhe rritja e fondeve dhe mbështetja financiare për këto pragame me rreth 10-15% më shumë se viti paraardhës;
- **Plani ynë për zhvillimin e sistemit arsimor do të pajisë studentët shqiptarë me dije** dhe afësi të konkurrenshme me bashkëmoshatarët e tyre në BE. Shkollat profesionale dhe universitetet do të përgatisin qytetarin e mirë dhe punonjësin e suksesshëm të vitit 2030-të. ( *Plani i Qeverisë 2021-2025 \_Objektivat për arsimin*).
- **Me investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe me sigurimin e integritet akademik** dhe shkencor të universiteteve, do të përmirësohet cilësia e produktit universitar me qëllim që diploma e çdo studenti të mbartë vlerën që duhet të ketë. ( *Plani i Qeverisë 2021-2025 \_Objektivat për arsimin*)
- **Me investimet infrastrukturore në kampuset/godinat universitare**, do të përmirësohet eksperiencia studentore dhe do të inkurajohen të rinjtë të ndjekin ëndrrat e tyre në kampuset universitare shqiptare. ( *Plani i Qeverisë 2021-2025 \_Objektivat për arsimin*).
- **Përmirësimi i standardeve infrastrukturore**, duke rritur raportin sipërfaqe/student së paku me 1 metër katror/student dhe vende për punë dhe kërkim në laboratorë e biblioteka. Do të synohet të sigurohet standardi 5-8 m2 për student, sipas natyrës së programit të studimeve në vitin 2022, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- **Synohet të sigurohet standardi, një vend pune për dy studentë në laborator kërkimorë shkencorë**, në përputhje me Kodine Cilësisë si dhe parimet e barazisë gjinore;
- Synohet që Fondet publike për IAL të arrijnë në 1.5% deri 2% ndaj PBB në vitin 2025;
- Synohet që 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit, të përfshihen në rregjistrin elektronik kombëtar, brenda vitit 2025.
- Synohet që 90% e stafit akademik me kohë të plotë, në departamente të jenë me grada/tituj brenda vitit 2025, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

- Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% në vitin akademik 2023-2024, rritje me 40% në vitin akademik 2024-2025 dhe 60% në vitin akademik 2025-2026.
- 100% e studentëve ekselencë, studentëve që studiojnë në degë dhe programet prioritare, si dhe studentët në nevojë do të përfitojnë bursa studentore në periudhën 2023-2025;
- Synohet që në vitin 2025, Raporti student/pedagog të arrijë 1 pedagog për 15 studentë.
- Synohet që numri i kërkuesve shkencorë për 1000 banorë deri në vitin 2025 të arrijë në nivelin e mesatares së vendeve të OECD;
- **Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpike për vitin 2023** në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpike, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistët elitari si dhe ato kandidat për lojërat olimpike verore, Paris 2024.
- **Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik, për vitin 2023**, pjesëmarrës në Lojërat Olimpike dhe lojërat olimpikë verore Paris 2024, mbështetje për aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa të Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- **Mbështetja financiare me investime në sport, për vitin 2023**, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, si dhe pajisjen me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare.
- **Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit**, trajnime çdo vit për 20-25% e stafit teknik të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trajnerë, specialistët, instruktorët, mjekët etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajnerët femra).
- **Rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitari**, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për të gjithë sportistët elitari, sipas kriterëve të miratuara në VKM nr. 789, datë 15.12.2021 si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe atij universitar.
- **Mbështetja me infrastrukturën e nevojshme materiale dhe njërzore për projektin “Ekipet Sportive”**, projekt i cili menaxhohet nga KOKSH-i me mbështetjen edhe të shkollave, zyrave dhe drejtorive arsimore si dhe MAS.
- **Përmirësimi i cilësisë së jetës së sportistëve dhe të rinjve në sport**, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre, në punësim, informim, edukim dhe vendimarrje.

### **Ndër objektivat dhe produktet/ aktivitetet/ shërbimet që janë financuar me përparësi, në këtë grup shpenzimesh për vitin 2023;**

- Finacimi i aktiviteteve të parashkuara për arsimin parashkollor**, aktualisht rreth 75.7% e fëmijëve 3-6 vjeç ndjekin arsimin parashkollor. Në vitin 2023-2025 synohet të sigurohet akses i fëmijëve në arsimin parashkollor në nivelin 85-85% për grupmoshën 3-6 vjeç, me qëllim që pas vitit 2022 akses i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor do të arrijë në nivelin 95-100%. Fondet grant të buxhetit për shërbimin në arsimin parashkollor, si dhe burimet njërzore për këtë shërbim, tanimë janë decentralizuar dhe aktualisht **administrohen dhe menaxhohen njësite e vetëqeverisjes vendore**.
- Mbi kurrikulën e re të arsimit parauniversitar**. Aktualisht, punojnë me kurrikulën e re bazuar në kompetenca si dhe me tekste të reja kl. I, II, III, VI, VII, VIII, X, XI. Deri në 2025, i gjithë sistemi arsimor parauniversitar do të punojë me kurrikulat dhe tekstet e reja, të njëjta me kurrikulat analoge të BE. Të kryejë analizë mbi përputhshmërinë e testeve kombëtare të klasës së IX dhe XII me programet orientuese, sipas kurrikulës me kompetenca (vijon nga 2019). **Të hartojë programet orientuese për provimet kombëtare të klasës V-të, IX-të dhe XII/XIII, për vitin shkollor 2022-2023.**
- Mbi Shërbimin Psiko-Social**, aktualisht ShPS në shkollat e arsimit të mesëm të lartë ofrohet sipas kësaj norme: Një psikolog dhe një punonjës social për çdo 2,800 nxënës, synohet që përcdo institucion arsimor me mbi 700 nxënës të këtë njëpunonjës psiko-social. Gjatë vitit 2022 çdo shkollë e mesme me mbi 700 nxënës do të këtë një psikolog dhe/ose një punonjës social duke arritur në rreth 850 punonjës psiko-socialë. .
- Mbi Zhvillimin Profesional të mësuesëve, për vitin 2021 -2022**, janë planifikuar të trajnohen 12,000 - 13,000 mësues me qëllim që të sigurohet efektivitet dhe cilësia e veprimtarive për zhvillimin profesional

mbështetur mbi nevojat për mësuesit dhe drejtuesit e insitucioneve shkollore si në nivel shkolle ashtu dhe ato të ofruara përmes sistemit kërkesë/ofertë.

- d) **Në këtë skemë përfshihen edhe trajnimet e mësuesëve të diasporës dhe minoriteteve.** Përkatesisht trajnimi i 40 mësuesve të minoriteteve dhe trajnimi i 100 mësuesve të diasporës për mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Fonde për të mbuluar shpenzimet për trajnimin çdo vit të 10-15% të punonjësve mësimorë të arsimit para-universitar.
- e) **Mbi Shkollat Qëndër Komunitare,** në vitin 2021-2022 do të rritet me 20% numri i shkollave SHQK. **Nga 225 shkolla aktualisht do të shtohen edhe 50 shkolla te tjera në 275 shkolla.** Cdo shkolle SHQK ka 10 orë mësimi në dispozicion për realizimin e aktiviteteve të ShQK-së, ku parashikohen rreth 500 orë mësimore shtesë, të cilat do të zhvillohen jashtë procesit mësimor, si aktivitete ekstra kurrikulare.
- f) **Licencimi i drejtuesve të insitucioneve shkollore, duke filluar nga viti akademik 2021-2022** në vijim, sipas një plani të mirëstudjuar të gjithë drejtuesit e insitucioneve arsimore parauniversitare do të certifikohen për drejtimin dhe administrimin e insitucioneve arsimore parauniversitare pranë **shkollës së drejtorëve,** e cila ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 2019.
- g) **Raporti nxënës për klasë, 2021-2022,** Në vitin 2022, synohet arritja e standardit evropian, jo më shumë se 25 - 30 nxënës për klasë në zonën urbane, jo më shkolla me dy tyne apo ora mësimorë paradite dhe pas dite, të cila do të mundësohet përmes investimeve në infrastrukturën shkollore.
- h) **Ofrimi i shërbimit të transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin rreth 38 000 nxënësve** që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 12 000 mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë, konform kërkesave të **VKM nr.692, datë 29.7.2015 në shumën 1 miliard 350 milion lekë në vit.**
- i) **Ofrimi i teksteve shkollore falas apo me rimursim pas blerjes për vitin 2022,** për të mbuluar shpenzimet për blerjen e teksteve shkollore për rreth 350 mijë nxënës të arsimit para-universitar, nga të cilët në arsimin 9-vjeçar nga klasa e parë në klasën e shtatë janë **rreth 260 mijë nxënës** që do të përfitojnë tekstet shkollore të detajuar për të gjithë nxënësit **nga klasa e parë në klasën e nëntë,** si dhe rreth **18-20 mijë nxënës në arsimin e mesëm të lartë,** që përfitojnë tekstet falas si dhe për nxënësit nga shtresat sociale në nevojë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë janë miratuar **rreth 945 milion lekë efektet e pritshme financiare parashikohet të arrijnë 950 milion lekë.**
- j) **Ofrimi i kuotës ushqimore, bursa me fonde të buxhetit të shtetit, për të mbuluar shpenzimet për kuotë ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta,** për gjithë arsimin parauniversitar janë rreth 2800 -2900 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë shuma parashikuar **prej 195 milion lekë në vit.**
- k) **Trajtimin me një kompensim shtesa mbi pagë të 12-13 mijë punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar, ku përveç pagës,punonjësit mësimorë, që punojnë larg vendbanimit, përfitojnë një kompensim financiar në masën, si më poshtë vijon:**  
*4.a) Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 2 700 (dy mijë e shtatëqind ) lekë në muaj.*  
*4.b) Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj, nga kjo masë përfitojnë rreth 12 000 punonjës mësimorë me një fond prej 200 milion lekë në vit .*
- l) **Rishikimin e kurikulës dhe hartimin e programeve të reja të arsimit para-universitar për veprimtarinë e Institutit të Zhvillimit të Arsimit si dhe për realizimin e funksioneve të inspektimit në arsim parauniversitar pas ristrukturimi në në, janë planifikuar 130 milion lekë në vit.**
- m) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për blerje materiale didaktike mësimore si dhe shërbim të tjera të arsimit para-universitar 60 milion lekë në vit,** ku përfitues janë rreth 350,000 nxënës të arsimit parauniversitar
- n) **Matura Shtetërore për vitin 2023,** për veprimtarinë e Maturës Shtetërore për rreth **30 mijë maturantë,** për dhënien e provimeve të shtetit, si dhe teste kombëtare e ndërkombëtare, janë planifikuar me **30 milion lekë,** pjesa tjetër e shpenzimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga tarifatat e shërbimeve.

**Financimin e veprimtarisë së IAL publike për vitin 2023 (programi buxhetor 09450), janë planifikuar fonde me burim financimi buxhetin e shtetit në shumën prej 11.58 miliard lekë, nga të cilat 10.4 miliard lekë janë në grupin e shpenzimeve korente “granti i mësimdhënies”, si dhe 1 miliard e 2180 milion lekë janë në grupin e shpenzimeve kapitale.**

**Shpërndarja e fonde me burim financimi buxhetin e shtetit në financimin e institucioneve të arsimit të lartë do të realizohet në përputhje me kërkesat nenit 7 pika c, neni 108, 110, 111,112 dhe 113 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në formë grant, si dhe kritereve të përcaktuara në VKM nr.75, datë 12.2.2018.**

Fondet e miratuara në formë “**grant për mësimdhënie**” për vitin 2023, janë në masën 10.4 miliard lekë, **këto fonde rishpërndahen** sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr.75, datë 12.2.2018, ku përfshihen fondet për mbulimin e shpenzimeve të personelit “Granti për mësimdhënie”, **në shumën 9 miliard lekë 53 milion lekë**, fondet për bursa financiare për studentët në shumën **prej 1 miliard 31 milion lekë**, mbështetje financiare për shoqëritë e **studntëve 300 milion lekë**, si dhe fonde grand për akreditim institucional të IAL si dhe të programeve të studimi ASCAL në shumën prej **15 milion lekë në vit.**

- **Fondeve grant për IAL publike për vitin 2023, pjesa e shpenzime korente, është planifikuar 10 miliard e 400 milion lekë, pas rimarrjes së fondeve grant të trashëguara nga viti 2022, fondet për IAL publike arritën në masën 11 miliard 938 milion lekë, janë kryesisht shpenzime personeli për IAL publike, realizimi 4-mujor 2023 është në masën 3 miliard 237 milion ose në masën 85% fondeve të planifikuara/rishikuara për 4-mujorin 2023, nga të cilat sipas natyrës së përdorimit janë;**

- a. **Shpenzimet nga fondet grant për shpenzime personeli si dhe shërbime të tjera të domosdoshme, për sigurimin cilësisë në arsimin e lartë, janë miratuar në masën 9 miliard e 259 milion lekë, fondet e realizuara për periudhën 4-mujore 2022, janë në masën 7 miliard e 882 milion leke ose në masën 87%. Së bashku me të adhurat këto shpenzime arrijnë në masën 11 miliard 459.6 milion lekë, fondet realizuara së bashku me të adhurat 10 miliard 82 milion lekë, realizimi i tyre është në masën 88%.**
- b. **Shpenzimet për mbulimin e bursave financiare për studentët në kuadrin e “Paktit për Universitet”, me rreth 1 miliard 31 milion lekë, buxheti i rishikuar 2022, pas rimarrjes së fondeve të kursyera nga viti 2021, është në masën 1 miliard e 287 milion lekë** ku përfitues parashikohen të jenë 11 800 studentë, realizimi për periudhën 4-mujorit 2023 është në masën **474.2 milion lekë ose 92%** ndaj planit 4-mujorit 2023.  
**Ky fond u jep mundësinë rreth 11,800 studentëve për të ndjekur studimet** në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, kategori të caktuara të studentëve sipas rezultateve dhe studentëve nga kategoritë sociale në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të përballuar një pjesë të kostos të studimeve kostot e shkollimit, sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar.
- c. **Fonde grant, për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e studentëve në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe”, për vitin 2023 janë parashikuar ku parashikohet të akomodohet rreth 6 mijë studentë, janë planifikuar 300 milion lekë në vit, realizimi është në masën 100.6 milion lekë ose në masën 100% e fondit të parashikuar për 4-mujorin parë 2023.**
- d. **Fonde grand për akreditim institucional si dhe të programeve të studimi ASCAL në shumën prej 15 milion lekë në vit, këto fonde parashikohet të realizohen në 4-mujorin tretë 2023.**

**Fonde në formë gradi për zhvillim, për financimin e investimeve në shumën prej 1 miliard e 180 milion lekë janë në grupin e shpenzimeve kapitale, nga të cilat 880 milion lekë janë me burim financimin nga buxheti i shtetit dhe 300 milion lekë janë me burim nga projekte financim u huaj.**

**Fondet e rishikuara për vitin 2023** me burim financim buxhetin e shtetit “**formë gradi për zhvillim**”, si dhe fonde grant të trashëguara nga kursimet e vitit 2023, arritën në shumën **1 miliard e 425 milion lekë**, realizimi për 4-mujorin 2023 është në masën 266.4 milion lekë ose në masën prej 43%.

- a. **Fondet grant për investime nga buxheti i shtetit së bashku me të ardhurat dytësore të IAL publike** për periudhën 4-mujore 2023 arritën në shumën prej **13 miliard 714.7 milion lekë**, realizimi është në masën **78% e fondeve të rishikuara për vitin 2023**.
- b. **Në total për vitin 2023, fondet të destinuar për investime kapitale në IAL publike**, fondet me burim financim buxhetin e shtetit “**formë gradi për zhvillim**”, si dhe nga të ardhurat e IAL publike të destinuar për investime kapitale, arritën **1 miliard e 425.1 milion lekë dhe realizimi për 4-mujorin 2023 është në masën 266.4 milion lekë, ose në masën 43% e fondeve të 4-mujorit vitit 2023**.
- c. **Fondet me Financim të Huaj plani fillesatar 2023**, është **300 milion lekë realizimi ose 6.5% e fondeve të miratuara** për investime për vitin 2023, ku janë duke implementuar 50 projekte me financim të huaj në programin e arsimit të lartë, plani i rishikuar për vitin 2023 është **300 milion lekë, realizimi për periudhën 4-mujore 2023 është në masën 23.4 milion lekë ose 8% e planit vjetor 2023**.
- d. **Fondet e miratuara për programin “Për Kërkim dhe Zhvillim” në buxhetin e miratuar për vitin 2023** ishin në masën 1 miliard e 31 milion lekë ose 0.05% ndaj PPB, si dhe 0.15% ndaj shpenzimeve publike. Fondet e rishikuara, së bashku me kursimet dhe të ardhurat e trashëguara për vitin 2022 arritën në masën 1 miliard 138 milion lekë, së bashku me të ardhurat arritën në masën 1 miliard 130.2 milion lekë ose afro 0.05% e PBB, si dhe në masën 0.17% ndaj shpenzimeve publike realimi i fondeve në këtë program për vitin 2023 arriti në masën 107.4 milion lekë ose rreth 70% e fondeve të rishikuara për vitin 2023
- e. **Nxitja e punës kërkimore në IAL**. Mbështetje financiare për Programet Kombëtare të Kërkim-Zhvillimit në IAL dhe institutet shkencore (Veprimtaria e AKKSHI), shuma e parashikuar e fondeve është në masën 30 milion lekë, shuma e realizuar për këtë produkt është në masën 7.1 milion lekë ose 80% e fondeve të planifikuara për këtë periudhë.
- f. **Financimi i Programe Kombëtare/Ndërkombëtare të Bashkepunimit Shkencor e Teknologjik të mbështetura financiarisht**, shuma e parashikuar e fondeve është në masën 173.6 milion lekë , shuma e fondeve të rishikuara është në masën 156 milion lekë, fonde të realizuara për këtë produkt është në masën 5.8 milion lekë ose 80% e fondeve të planifikuara për këtë periudhë.
- g. **Fonde për financimin e projekte kërkimore shkencore, financim në formë grant “Financime grant per universitetet në bashkëpunim me bizneset”, në shumën prej 82.2 milion lekë, fondi i rishikuara është në masën 121.6 milion lekë** fonde grant me financim të brendshëm, realizimi për periudhën 4-mujore është në masë 9.5 milion lekë.
- h. **Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër “Horizon Europe”**. Program i BE-së për Kërkim dhe Inovacion, pjesëmarrje e që premtan arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë së Europës në nivel global, për vitin 2023 janë parashikuar 100 milion lekë nga buxheti i shtetit si dhe 80 milion lekë nga të ardhurat, për pagesa kuota anëtarësie transferta ndërkombëtare shuma prej **180 milion lekë, nga të cilat shuma prej 100 milion lekë**, është planifikuar të paguhet me fonde grand nga buxheti **si dhe 80 milion lekë nga rimbursimi i fondeve grand të BE**, për këtë marrëveshje. Pagesa për pjesëmarrjen në programin e Unionit Horizon Europe, është planifikuar për tu paguar brenda dates 15 Shtator 2022.
- i. **Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër, ERASMUS+ “Marrëveshja midis Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrjen në Programin "Erasmus+ për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin”, ratifikuar me Ligjin nr. 17/2014, datë 11.9.2014. është parashikuar kontributi financiar 90.000 (nëntëdhjetë mijë) Euro/vit, parashikuara për paguar me fonde grand nga buxhetit, si dhe nga rimbursimi i fondeve grand të BE. Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen në programin e nismës për reformën arsimore në vendet e Evropës Juglindore, ERI SEE, pagesa e kuotës vjetore “Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e nismës për reformën arsimore në vendet e Evropës Juglindore (ERI SEE)”, për vitin 2023, në shumën prej 3.4 milion lekë, është paguar me fonde grand nga buxheti dhe nga të ardhurat.**



- j. **Fonde të miratuara në formë grant, për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve ekselencë** që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitetet më të mira të botës; janë parashikuar **çdo vit 100 milion lekë**, fondi i rishikuar ishte në masën 121.04 milion lekë dhe realizimi arrit në masën 110.2 milion lekë ose në masën 91%.
- k. **Fonde për financimin e projekte kërkimore shkencore, zhvillimin e kapaciteteve akademike në shumën prej 550 milion lekë**, nga të cilat 250 milion fonde me financim të brendshëm si dhe 300 milion financim i huaj. Pas rishikimi këto fornde aritën në masën 550 milion lekë nga të cilat 250 milion fonde me financim të brendshëm si dhe 300 milion financim i huaj. Shtuar dhe të ardhurat këto fonde aritën në masën 556.1 milion lekë, realizimi ishte në masën 45.1 milion lekë ose në masën 50%.

## **Fondet miratuara për vitin 2023, të detajuara sipas grupartikujve buxhetorë.**

### **A- Fondet e miratuara për shpenzime personeli.**

- **Fondet për shpenzime personeli për vitin 2023**, janë miratuar në masën 28 miliard e 829.milion lekë ose në masën 61.1% e fondeve të miratuara për arsimin për vitin 2023. Shpenzimet e personelit të miratuar për vitin 2023 janë rreth 61.1% e buxhetit të arsimit, ndërsa ndaj shpenzimeve totalit të shpenzimeve korentë janë në masën 69.5%.
- Fondet e miratuara për shpenzime personeli përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve, të numrin të miratuar të punonjësive të miratuar me ligjin vjetor prej **31 005 punonjës të arsimit**, si dhe 2 300 praktikantëve që realizojnë praktikën profesionale në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar për vitin 2022-2023.
- **Fondet e shpenzimeve për personelin “Të rishikuara” për vitin 2023**, pas rishpërndarjes të fondeve grant për financim të shpenzimeve të personelit, në IAL publike për vitin 2023, pa përfshirë të ardhurat e realizuara nga IAL publike arrijnë në shumën prej **37 miliard 524 milion lekë ose 76.8% të shpenzimeve për arsimin.**
- **Fondet e shpenzimeve për personelin “të rishikuara”, për vitin 2023** pas rishpërndarjes të fondeve grant për financim të shpenzimeve të personelit në IAL publike për vitin 2023, **shtuar/ përfshirë të ardhurat e realizuara nga IAL publike** që shkojnë për financim të shpenzimeve të personelit, arrijnë në shumën prej **37 miliard 612 milion lekë** ose 75.5 % të shpenzimeve për arsimin.
- **Realizimi për 4-mujorin Janar -30 Prill 2023** është në masën në **12 miliard 448 milion lekë** krahasuar me planin 4 mujor 2023, është në masën **88%**, në strukturën shpenzimeve të realizuara, grupi i shpenzimeve për personelin arrijnë në masën 84.0% të shpenzimeve për arsimin. **Shtuar fondet e realizuara nga të ardhurat e realizuara nga IAL publike** që shkojnë për financim të shpenzimeve të personelit, arrijnë në shumën prej **12 miliard 536 milion lekë** ose 85.4 % të shpenzimeve për arsimin.

### **B- Fondet për shpenzime korente/operative për blerje mallra dhe shërbime;**

Fondet e miratuar për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbime nga të tretë për vitin 2023, janë në masën **13 miliard 790.1 milion lekë ose 29.2 % e buxhetit** të miratuar për vitin 2023.

- Fondet e shpenzimeve korente për vitin 2023, **pas rishpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar në IAL publike** arrijnë në 6 miliard 797 milion lekë ose 13.9% e fondeve të miratuara për vitin 2023.
- **Fondet e buxhetit të rishikuar, së bashku me të ardhurat e IAL publike për vitin 2023**, arriti në shumën prej 7 miliard 105.4 milion lekë ose 14.3% e fondeve për arsimin 2023.
- **Realizimi i fondeve për shpenzimeve të korente me burim financimi nga buxheti i shteti, për 4- mujorin 2023**, është në masën 1 miliard 361 milion lekë, krahasuar me planin 4-mujor është realizuar në masën 80% e fondeve të miratuara për vitin 2023.
- Realizimi i shpenzimeve korente **fondet buxhetit të shtetit së bashku me të ardhurat** për vitin 2023, arrin në masën 1 miliard 575.8 milion lekë krahasuar me planin 4-mujor është në masën **79%**, në strukturë shpenzimet të realizuara për arsimin **arrijnë në masën 10.7% të shpenzimeve për arsimin 2023.**

**Zërat kryesorë në këtë grupartikull të shpenzimeve të tjera korrentë janë;**

- Shpenzime për transportin e rreth 38 mijë nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e mësuesve 12 000 mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë me 1 miliard 52.2 milion lekë të planifikuara, fondet e rishikuara janë në masën 1 miliard 52.2 milion lekë dhe fondet e realizuara janë 340.4 milion lekë, ose 32.3% e fondeve të planifikuara për vitin 2023.
- Trajnimi i mësuesve te arsimit parauniversitar, per implementimin e kurikulave e programeve mesimore, rritjen e kompetencave profesionale mësues të arsimit parauniversitar te trajnuar per kurrikulen e re, si dhe “Kurrikula lëndore dhe programe te hartuara”, fondet e rishikuara për vitin 2023 janë në masën 148 milion lekë, fondet e rishikuara janë në masën 148.5 dhe fondet e realizuarapër 4 mujorine parë 2023 janë 29.5 milion lekë, ose 20% e planit vjetor 2022.
- Shpenzime për shërbime arsimore, blerje dokumentacion shkollor, blerje mjete didaktike dhe shërbime të tjera arsimore likuidimi i vendimeve gjyqësore dhe detyrime të tjera ndaj të tretëve, fondet e miratuara 36.6 milion lekë, fondet e rishikuara për vitin 2023 janë në masën 36.6 milion lekë dhe fondet e realizuara janë 8 milion lekë, ose 21.8 % e planit vjetor 2023.
- Shpenzime për transfertat tek individët për blerjen e teksteve shkollore 1 miliard e 98 milion lekë, buxheti i rishikuar 1 miliard e 98 milion lekë, realizimi i fondeve të rishikuara për vitin 2023 parashikohet të realizohet ne muajin Shtator -tetor 2023.
- Shërbime arsimor për fëmije, nxënës me atësi të veçanta (instituti special që nuk dëgjojnë dhe institut që nuk shikojnë, që përfitojnë shërbim arsimor në institucione të veçanta apo speciale), rreth 105.8 milion lekë, buxheti i rishikuar është 32.4 milion lekë, realizimi 4 mujor 2023 është në masën 32.4 milion lekë ose në masën 30.6%.
- Shpenzime për bursat, për nxënës nga grupe sociale në nevojë që përfitojnë shërbim arsimor me 266.3 milion leke të planifikuara, buxheti i rishikuar është 266.3 milion lekë, realizimi 4 mujor 2023 është në masën 36.6 milion lekë ose në masën 13.7%. (Fonde të miratuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore)
- Fonde për të mbuluar shpenzimet për veprimtarinë e Maturës Shtetërore, provimet e shtetit , si dhe testime kombëtare e ndërkombëtare me 30 milion lekë në vit këto fonde janë relazuar në masën 1.6 milion lekë dhe realizimi i tyre pritet në muajin Maj-Qershor 2023, si dhe Shtator 2023.

### **Fondeve grant për IAL publike për vitin 2023;**

- Fondeve grant për IAL publike për vitin 2023, janë miratuar në masën 11.58 miliard lekë, ku pjesa e shpenzime korente, është planifikuar 10 miliard e 400 milion lekë, pas rimarrjes së fondeve grant të trashëguara nga viti 2022, fondet për IAL publike arritën në masën 11 miliard 938 milion lekë, janë kryesisht shpenzime personeli për IAL publike, realizimi 4-mujor 2023 është në masën 3 miliard 237 milion ose në masën 85% fondeve të planifikuara/rishikuara për 4-mujorin 2023, nga të cilat sipas natyrës së përdorimit janë;
  - a. Shpenzimet nga fondet grant për shpenzime personeli si dhe shërbime të tjera të domosdoshme, për sigurimin cilësisë në arsimin e lartë, janë miratuar në masën 9 miliard e 053 milion lekë, fondet e rishikuara për periudhën 12-mujore 2023, janë në masën 10 miliard e 367 milion leke, fondet realizuara së bashku me të ardhurat 2 miliard 667.1 milion lekë, realizimi i tyre është në masën 78% e fondeve të parashikuara për 4 mujorin 2023. Së bashku me të ardhurat këto shpenzime arrijnë në masën 11 miliard 459.6 milion lekë, fondet realizuara së bashku me të ardhurat 2 miliard 667 milion lekë, realizimi i tyre është në masën 80% e fondeve të parashikuara për 4-mujorin 2023.
  - b. Shpenzimet për mbulimin e bursave financiare për studentët në kuadrin e “Paktit për Universitet”, me rreth 1 miliard 31 milion lekë, buxheti i rishikuar 2023, pas rimarrjes së fondeve të kursyera nga viti 2022, është në masën 1 miliard e 287.5 milion lekë ku përfitues parashikohen të jenë 11 800 studentë, realizimi për periudhën 4-mujore 2023 është në masën 474.2 milion lekë ose 92% ndaj planit 4-mujorit 2023. Ky fond u jep mundësinë rreth 11,800 studentëve për të ndjekur studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, kategori të caktuara të studentëve sipas rezultateve dhe studentëve nga kategoritë sociale në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të përballuar një pjesë të kostos të studimeve kostot e shkollimit, sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të

Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar.

- c. **Fondet grant, për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e studentëve në tetë** “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe”, për vitin 2022 janë parashikuar ku parashikohet të akomodohet **rreth 6-700 mijë studentë**, janë planifikuar **300 milion lekë në vit, realizimi është në masën 100 milion lekë ose në masën 100% e fondeve të planifikuara për 4-mujorine parë 2023.**
001	11	1011136	Universiteti "I.Qemali", Vlore (3737)	02	09770	231	3737	18CJ924	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Sustainable University - Enterprise Cooperation for Improving Graduate Employability- SUCCESS	4,200,000	382,150	9.1%
001	11	1011136	Universiteti "I.Qemali", Vlore (3737)	02	09770	231	3737	18CJ926	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_MSc course in STEAM education - STEAMedu	2,113,920	427,290	20.2%
001	11	1011136	Universiteti "I.Qemali", Vlore (3737)	02	09770	231	3737	18CJ928	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Economic enhancement of knowledge in the food sector strengthening the technological transfer offices in albanian universities- TTO4FOOD	1,000,000	4,210	0.4%
001	11	1011136	Universiteti "I.Qemali", Vlore (3737)	02	09770	231	3737	20AB203	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Projekti "Sustainable development of Blue economies through higher Education and innovation in Eastern Balkan Countries, BLUEËBC"	2,256,900	1,410,310	62.5%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	231	3535	20AB204	Universiteti i Tiranës_Projekti "Skadar Lake without chemical pollution-SOLUTION"	2,210,000	641,750	29.0%
001	11	1011237	Agjencia Kombetare e Kerkimit Shkencor dhe Inovacionit (3535)	02	09770	231	3535	20AB206	AKKSHI_Projekti "U-SIA MASR"	300,000	30,390	10.1%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	231	3535	20AB207	Projekti "STAND UT" ne Universitetin e Tiranës	3,700,000	156,080	4.2%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	231	3535	20AB208	Projekti "STEAMedu UT" ne Universitetin e Tiranës	5,500,000	857,010	15.6%
001	11	1011199	Rektorati i Universitetit te Mjekesise Tirane (3535)	02	09770	231	3535	20AB209	Projekti "IDEA UMT" në Universitetin e Mjekësisë Tiranë	4,562,922	750	0.0%
001	11	1011199	Rektorati i Universitetit te Mjekesise Tirane (3535)	02	09770	231	3535	20AB210	Projekti DigiCare4You " Nje zgjidhje inovative ndersektoriale qe perfshin mjete DIGital, fuqizimin e familjeve dhe integrimin e sherbimeve CARE ne komunitet dhe parandalimin dhe menaxhimin e diabetit te tipit 2 te hipertensionit	11,600,000	1,844,250	15.9%
001	11	1011040	Universiteti Politeknik (3535)	02	09770	231	3535	20AB212	UPT_Projekti EUSIS	2,000,000	1,500	0.1%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	231	3535	20AB233	UT_Projekti EU-HSTEU1	1,200,000	810	0.1%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	231	3535	20AB234	UT_Projekti OËNERSHIP-in EU	1,300,000	770	0.1%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	231	3535	20AB235	UT_Projekti EPPAL	3,500,000	8,710	0.2%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	231	3535	20AB238	UT_Projekti SUSNANO	10,500,000	3,722,910	35.5%
001	11	1011039	Universiteti i Tiranës (3535)	02	09770	230	0000	GM11031	Përmirësimi i l mbrojtjes dhe mireqenies se femijeve ne Europe	-	900	#DIV/0!
001	11	1011237	Agjencia Kombetare e Kerkimit Shkencor dhe Inovacionit (3535)	02	09770	230	0000	GM11035	Financim i huaj per projekte te kerkimit shkencor	-	750	#DIV/0!

## Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluar dhe krijuara rishtazi për vitin 2023.

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe udhëzimit nr.5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, **Shtojca 3, udhëzimit nr.37, datë 6.10.2020**, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për monitorimin dhe publikimin periodik të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, **ju informojmë mbi detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 31 qershor 2022, për Aparatin e MAS dhe institucionet e varësisë** i detajuar sipas “

**Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Janar 31 Mars 2023;**

1. **Shkresa nr. 673/1, datë 01.02.2023 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë** “Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për vitin 2022”. (mbështetur në raportimet financiare të 80 institucione të sistemit të arsimit)
2. **Raporti i Auditimit të Brendshëm në MAS nr. 7765/2, datë 29.12.2022** "Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe analizimin e masave të marra për parandalimin e krijimit e detyrimeve financiare dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", për periudhën 01.01.2021 deri më 30.11.2022;
3. **Shkresa nr.2394/1, datë 3.5.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë** “Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi” për periudhën Janar -Mars 2023.(mbështetur në raportimet financiare të 80 institucione të sistemit të arsimit).

Vlera e detyrimeve të prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 31.03.2023 sipas njësive shpenzuese të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit paraqitet sa më poshtë:

Tab.1 “Masa e detyrimeve të krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 31.03.2023”

Ministria e Linjës	Detyrimet e prapambetura të akumuluar në fund të periudhës 31.03.2023						
	Gjendja në fillim të periudhës 1.01.2022		Detyrime të krijuara rishtazi 3 mujori i parë 2023		Likuiduar deri 31.03.2023	Gjendja në fund të periudhës 31.03.2023	
	në lekë	në %	në lekë	në %	në lekë	në lekë	në %
<b>Ministria e Arsimit dhe Sportit:</b>	<b>2,595,736</b>	<b>100%</b>	<b>6,799,092</b>	<b>101</b>	<b>147,624</b>	<b>9,247,204</b>	<b>100%</b>
Institucione e arsimit parauniversitar (DPAP, DRAP, ZVA)	2,595,736	100	6,144,508	90.37	147,624	8,592,620	92.92
Institucione të tjera	0	-	654,584	10.65	-	654,584	7.08
<b>IAL Publike</b>	<b>0</b>	<b>-</b>	<b>0</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Për sa më sipër vihet re se:

- A. Detyrimet e krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 31 Mars 2023, nuk janë raportuar për **institucionet publike të arsimit të lartë**, pasi bazuar në ligjin nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, IAL Publike gëzojnë autonomi financiare dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura realizohet me të ardhurat e krijuara nga këto institucione, duke mos rënduar buxhetin e shtetit.
- B. Detyrimet e krijuara rishtazi dhe akumuluar deri me 31 Mars 2023, për njësitë shpenzuese të MAS, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre më fonde buxhetore, paraqiten sa më poshtë përkatësisht:
  - ✓ Gjendja e detyrimeve në fund të vitit 2022, paraqitet në masën 2.6 milion lekë ose 100 e % të detyrimeve të raportuara.
  - ✓ Detyrime të krijuara rishtazi në 3 mujorin e parë 2023 paraqiten në masën 6.7 milion lekë dhe akumuluar në fund të kësaj periudhe paraqiten në masën 9.2 milion lekë.

Nga sa më sipër, vihet re një rritje e detyrimeve të prapambetura afro 2 herë më shumë në krahasim me detyrimet e raportuara një vit më parë (ose në fillim të periudhës), dhe e detajuar kjo sipas njësive shpenzuese paraqitet sa më poshtë:

Tab. 2\_ “Masa e detyrimeve të prapambetura e detajuar sipas njësive shpenzuese të MAS”:

Kodi Qeverisjes	Ministria e Linjes	Emri i Institucionit	Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar deri në 31.03.2023						
			Gjendja në fillim të periudhës 1.01.2023		Detyrime të krijuara rishtazi 31.03.2023		Likuiduar deri 31.03.2023	Gjendja në fund të periudhës 31.03.2023	
			në leke	në %	në leke	në %	në leke	në leke	në %
01	11	Zyra Vendore Arsimore, Bulqizë	229,560	8.8	-	-	-	229,560	2.5
01	11	Zyra Vendore Arsimore, Dibër	2,366,176	91.2	3,010,136	44.3	147,624	5,228,688	56.5
01	11	Zyra Vendore Arsimore, Kamëz	-	-	119,024	1.8	-	119,024	1.3
01	11	Zyra Vendore Arsimore, Klos	-	-	858,663	12.6	-	858,663	9.3
01	11	Zyra Vendore Arsimore, Mirdite	-	-	1,164,000	17.1	-	1,164,000	12.6
01	11	Zyra Vendore Arsimore, Tepelene - Memaliaj	-	-	992,685	14.6	-	992,685	10.7
01	11	ASCAP Tirane	-	-	654,584	9.6	-	654,584	7.1
		<b>TOTALI</b>	<b>2,595,736</b>	<b>100</b>	<b>6,799,092</b>	<b>100</b>	<b>147,624</b>	<b>9,247,204</b>	<b>100</b>

Sikurse paraqitet më sipër detyrimet e krijuara rishtazi dhe akumuluar për 3 mujorin e parë të vitit 2023 nga njësitë shpenzuese të MAS paraqiten në masën 9.3 milion lekë e detajuar sipas njësive shpenzuese:

1. Zva Dibër në shumën 5.2 milion lekë ose 56.5 % të detyrimeve të akumuluar dhe krijuar rishtazi
2. Zva Mirditë në shumën 1.16 milion lekë ose 12.6 % të detyrimeve të akumuluar dhe krijuar rishtazi
3. Zva Tepelenë – Memaliaj në shumën 992.7 mijë lekë ose 10.7 % të detyrimeve të akumuluar dhe krijuar rishtazi
4. Zva Klos në shumën 858.7 mijë lekë ose 9.3 % të detyrimeve të akumuluar dhe krijuar rishtazi
5. ASCAP Tiranë në shumën 654.6 mijë lekë ose 7.1 % të detyrimeve të akumuluar dhe krijuar rishtazi
6. Zva Bulqizë në shumën 229.5 mijë lekë ose 2.5 % të detyrimeve të akumuluar dhe krijuar rishtazi
7. Zva Kamëz në shumën 119 mijë lekë ose 1.3 % të detyrimeve të krijuara rishtazi

Duke analizuar historikun e detyrimeve të prapambetura, problematikat e situatës, shkakun dhe arsyen e pamundësisë për të shlyerjen në kohë të detyrimeve kontraktore dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë si rezultat i mungesës së fondeve buxhetore, detyrimet e prapambetura sipas natyrës së krijimit paraqiten sa më poshtë:

Tab 3\_ Detyrimet e prapambetura të akumuluar në fund të periudhës sipas natyrës së detyrimit deri me 31.03.2023

Nr.	Ministria e Linjës	Detyrimet e prapambetura të akumuluar në fund të periudhës sipas natyrës së detyrimit deri me 31.03.2023						
		Gjendja në fillim të periudhës 1.01.2023		Detyrime të krijuara rishtazi 31.03.2023		Likuiduar në 3/ mujorin e parë 2023	Gjendja në fund të periudhës 31.03.2023	
		në leke	në %	në leke	në %	në leke	në leke	në %
	Totali i detyrimeve sipas natyrës së detyrimit:	<b>2,595,736</b>	<b>100</b>	<b>6,799,092</b>	<b>100</b>	-	<b>9,247,204</b>	<b>100</b>
1	Ekzekutim vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim nga puna	2,595,736	100	2,275,709	33	147,624	4,723,821	51
2	Ekzekutim vendimeve gjyqësore të formës së prerë	-	-	-	-	-	-	-
3	Blerje pajisje (detyrime kontraktore)	-	-	-	-	-	-	-
4	Shërbim transporti nxënës & mësues	-	-	-	-	-	-	-
5	Rimbursim TVSH	-	-	-	-	-	-	-
6	Shteti tatim taksa	-	-	-	-	-	-	-
7	Blerje kancelari, materiale, shërbime të tjera	-	-	4,523,383	67	-	4,523,383	49
8	Rikonstruksione objektsh + ndërtime të reja	-	-	-	-	-	-	-

Sa më sipër vihet re se masën më të madhe të detyrimeve të krijuara rishtazi dhe akumuluar për 3 mujorin e parë të vitit 2023 e zënë detyrimet nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë të cilat paraqiten në fund të periudhës në masën 4.7 milion lekë ose 51 % të detyrimeve të krijuara rishtazi dhe akumuluar si dhe detyrime për blerje kancelari, materiale shërbime të tjera në masën 4.5 milion lekë ose 49% të detyrimeve të krijuara rishtazi dhe akumuluar.



- 2 Rekurse
- 6 kallëzime penale

2 kërkesa për heqje dorë nga gjykimi në lidhje me kërkesë paditë e FE, për shkak se përfituesit e FE kanë përmbushet detyrimet ligjore ndaj MAS duke kthyer shumë e përfituar nga FE.

## VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË MIRATUARA PËR VITIN 2023

1. **Vendim nr. 17, datë 18.1.2023** “Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të komplekseve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës”. (Jashtë PPAP)
2. **Vendim nr. 18, datë 18.1.2023** “Për miratimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Ballkanin perëndimor”. (Jashtë PPAP)
3. **Vendim nr. 35, datë 27.1.2023** “Për miratimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore”. (Jashtë PPAP)
4. **Vendim nr. 119, datë 1.3.2023** “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”. (Planifikuar në PPAP)
5. **Vendim nr. 186, datë 29.3.2023** “Për një ndryshim në vendimin nr. 430, DATË 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Tiranës”, të ndryshuar (Jashtë PPAP)
6. **Vendim nr. 256, datë 20.4.2023** “Për një ndryshim në vendimin nr. 67, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e gjashtë anëtarëve në përbërje të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, të përzgjedhur me konkurrim publik” (Jashtë PPAP)
7. **Vendim nr. 338, datë 31.5.2023** “Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj” (Planifikuar në PPAP).

## UDHËZIME TË MIRATUARA PËR VITIN 2023

1. **Udhëzim nr. 1, datë 10.1.2023** “Për një shtesë në udhëzimin nr. 36, datë 25.9.2015, “Për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar”
2. **Udhëzim nr. 2, datë 8.2.2023** “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”
3. **Udhëzim Nr. 3, datë 15.2.2023** “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike” (ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 6.3.2023)
4. **Udhëzim nr. 5, datë 17.2.2023** “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në republikën e shqipërisë, viti shkollor 2022-2023 (sesioni i parë)”
5. **Udhëzim nr. 6, datë 27.2.2023** “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2023”
6. **Udhëzim nr. 7, datë 6.3.2023** “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2023, “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike”
7. **Udhëzim nr. 8, datë 16.3.2023** “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 32, datë 23.12.2022, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore dhe të maturës shtetërore profesionale 2023”.
8. **Udhëzim nr. 9, datë 21.3.2023** “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
9. **Udhëzim nr. 10, datë 16.6.2023** “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015, “për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar””. (i pa publikuar ende ne qbz).

**Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për 4-mujorin e parë 2023, ka realizuar detyra si më poshtë;**



1. Miratimi, shpërndarja, ndjekja e zbatimit të **fondeve të buxhetit për vitin 2023**, të miratuara me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”,
  - a) **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 8507/1, date 30.12.2022;
  - b) Miratimi, shpërndarja e fondeve të buxhetit për të gjitha institucionet e sistemit të MAS, për vitin 2023-2025,; **Shkresa** e miratuar nga Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 23774/36, date 20.01.2023;
  - c) Miratimi, **shpërndarja e shpenzimeve mujore** të fondeve për të gjitha institucionet e sistemit të MAS, për vitin 2023; **Shkresa** e miratuar nga Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 23774/95, date 25.01.2023
2. Hartimi dhe **shpërndarja e fondeve të investimeve nga buxhetit** për institucionet e sistemit të MAS, për periudhën afatmesme 2023-2025;
  - a) **Shkresa** e dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 23774/36, date 20.01.2023; Hartimi dhe **shpërndarja e fondeve për investimet** për institucionet e sistemit të MAS, për periudhën afatmesme 2022-2024, **Shkresa** dërguar për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr.937, date 8.02.2023;
  - b) **Shkresa** e miratuar nga Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 23774/174, date 09.03.2023; **Shkresa** e miratuar nga Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë **për limitin e shpenzimeve mujore** nr. 23774/180, date 27.03.2023
3. **Hartimi i planit të shpenzimeve në valutë** për institucionet arsimore për vitin 2023 ; **Shkresa** dërguar për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr.937, date 8.02.2023;
4. **Përgatitja e Deklaratës Vjetore “Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vitin 2022”. Plotësimi i Pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2022.** (pyetjeve të pyetësorit sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (Neni 19, i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar).; Plotësimi i regjistrit të Riskut për DBMF 2022-2023. **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 1389/1, date 01.03.2023
5. **Përgatitja e raportit të monitorimi të konsoliduar, të zbatimit të buxhetit për vitin 2022**, së bashku me anekset e monitorimit (aneksi 13-të) për vitin 2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 12 muaj Janar – Dhjetor 2022; **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 1389/3, date 01.03.2023;
6. **Raportime në Ministrinë e Financave për detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi nga zbatimi i vendimet gjyqësore** të formës së prerë të likujdura me fonde buxhetore janar –dhjetor 2022, **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 673/1, datë 01.02.2023;si dhe për periudhën 3-mujorin e parë 2023, **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 234./1, datë 03.04.2023;
7. **Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2022; Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 2802, date 28.04.2023;
8. **Mbështetja me ekspertize për financat dhe buxhetin** për përgatitjen e kapitujve 25 dhe 26 të Acquis Communautaire. Janë hartuar dhe dërguar përgjigje kontribute në kuadër të nën-komiteteve dhe komiteteve të ndryshme siç janë ai i Çështjeve Ekonomike e Financiare, Komiteti Stabilizim Asociimit, Inovacioni, Shoqëria Informacionit dhe Politikat Sociale, si dhe plotësimi i rekomandimeve afatshkurtra të raportit të Komisionit Evropian;
9. **Hartimi i PBA 2024-2026. (Faza e parë)** Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2020-2022), në zbatim të Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, **Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018** “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, **Udhëzimit Plotësues nr.5, datë 28.2.2023** të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen se Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”; si dhe **Vendimin nr. 195, datë 005.04.2023** të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 2546/1, date 02.05.2023;

10. Kërkesat "**Fonde për Shtese 2024-2026**", nga MAS është dërguar shkresa e ne MFE nr. 1641/4, datë 02.05.2023;
11. Raportime në Ministrinë e Financave për **detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi për vitin 2023**, si dhe borxhet e mbartuara nga viti 2022, **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 673/1, datë 01.02.2023; si dhe për periudhën 3-mujorin e parë 2023, **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 234./1, datë 03.04.2023;
12. Raportime në Ministrinë e Financave **për shpenzimet në valutë për institucionet arsimore**, për vitin 2022 **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 262/9, datë 25.01.2023; Raportimi për 3-mujorin 2023; **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 2973/1/29, datë 15.5.2023;
1. **Analizë dhe përgatitje e shkresave/autorizimeve** për nëpunësin autorizues si dhe nëpunës zbatues të institucioneve arsimore.
2. **Analizë dhe përgatitje e autorizimeve për udhëtime e dieta të punonjësve** të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
3. **Analizë dhe përgatitje e autorizimeve për pagesën nga fondi i vecantë të punonjësve** të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
4. **Pjesmarrja në grupe pune**, për hartimi i projekt akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar dhe universitar në tërësi dhe për pjesën financiare në veçanti, konform Matricës së akteve ligjore dhe nënligjore të parashikuara për vitin 2023.
5. **Planifikimi dhe ndjekja e procedurave për implementimin e projekteve me financim të huaj**, mbështetur ne Planin Vjetor të Reformes si dhe ndjekja dhe monitorimi i projekteve dhe pagesave të projekteve të tjera të huaja (**kosto lokale dhe TVSH**). Raportimi në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë **për çdo muaj** sipas kërkesave specifike.
6. **Në kuadër të planit të integritit evropian**, është hartuar Kontributi i Qeverisë Shqiptare për Progres Raportin/ Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura", **Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor"** për pjesën e fondeve në arsim sipas kapitujve;
7. Është hartuar Kontributi i III i Qeverisë Shqiptare për Progres Raportin/ ne muajin prill 2023, për **Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"**, Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor", **për pjesën e fondeve në arsim sipas kapitujve**);
8. Janë hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Intergrimit, për MEPJ, si dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kontribute në kuadër të nën-komiteve dhe komiteve të ndryshme siç **janë ai i Çështjeve Ekonomike e Financiare**, Komiteti Stabilizim Asociimit, Inovacioni, Shoqëria Informacionit dhe Politikat Sociale, si dhe plotësimi i rekomandimeve afatshkurtra të raportit të Komisionit Evropian.
9. **Monitorime analiza për produktet kryesore**, si numri i punonjësve, pagave të punonjësve si dhe shpenzime personeli në Arsim, transportin e nxënësve dhe mësuesve, bursat dhe kuotat ushqimore, tekstet shkollore dhe kompesimi i tyre, investimet kapitale, si dhe trajtimi i problematikave në arsimin e lartë në IAL publike, etj.
10. **Pjesëmarrje në grupe pune në MAS**, për hartimin projektvendimeve, projektudhëzimeve dhe projektudhëzimeve, apo akte të tjera nënligjore në kuadër të reformës në arsim.
11. **Realizimi i rishpërndarjeve të fondeve të buxhetit për vitin 2023**, miratuar me ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023".
12. Pjesëmarrje në grupe pune në MAS, për hartimin e specifikimeve teknike si dhe fondit limit për procedura prokurimi publik të parashikuara për vitin 2023.
13. **Hartimi i projektvendimeve të hartura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar**, si dhe hedhja në sistem e projektvendimeve, për të cilat jemi ngarkuar.
14. **Ndjekja dhe monitorimi i detyrimeve të prapambetura**, në zbatim të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", **janë realizuar analiza dhe dërguar raporte dhe informacione për Titullarët dhe në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për vitin 2023, për 3-mujor, si dhe progresiv vjetor 2023**, i detajuar me të dhëna lidhur me:
  - a) *Historikun e detyrimeve të prapambetura, problematikave e situatës, shkaqet dhe arsytet e pamundësisë së deritanishme për të shlyer këto detyrime, masat konkrete të marra deri tani në këtë drejtim;*

- b) *Detyrimet e krijuara rishtazi dhe të akumuluarra deri në 31 mars 2023;*
- c) *Vlera e likuiduar e detyrimeve të prapambetura deri më 31 mars 2023;*
- d) *Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin 2023, si edhe për një periudhë afat-mesme 2023-2025.*

**15. Monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve**, përdoren një sërë procedurash nga titullarët, nëpunësit Autorizues dhe zbatues si dhe drejtuesit e tjerë të lartë. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për e monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA.

**DBNJ\_ Përmirësimi i cilësisë së shërbimit arsimor, në institucionet e arsimit parauniversitar, detyrat e realizuara për 4-mujori janar-prill 2023, janë si vijon.**

1. Për periudhën janar- prill 2023, në bashkëpunim me DAP, janë realizuar procedurat për rekrutim për plotësimin e nevojave të institucionit për **20 pozicione vende** vakante në shërbimin civil. Ndjekja e të gjithë procesit të shpalljes së vendeve vakante në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, marrja e masave dhe kryerja e praktikave për caktimin e punonjësve të MAS për **20 procedura në Komisionet e përzgjedhjes së kandidatëve**, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Bazuar në legjislacionin në fuqi është bërë praktika për **12 emërime** në pozicione administrative dhe politike, **1 praktikë pezullimi të statusit të nëpunësit civil**, **1 praktikë për procedurën e ngritjes në detyrë**, **1 lirim në pozicione të emëruar me kod pune**, **1 praktikë** zgjidhje kontrate të punës së një punonjësi të emëruar me kod pune.
3. Ndjekja e procesit të **konfirmimit të 1 punonjësi të MAS dhe kryerja e praktikës përkatëse**, si nëpunës civil, pas përfundimit të periudhës 1-vjeçare të provës në shërbimin civil.
4. Nënshkrimi i kontratave të punës me **7 praktikantë** të punësuar nga Programi Kombëtar i Praktikave të Punës bazuar në Vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar", dhe **10 punonjës me kontratë mbi numrin organik** bazuar në vendimin nr. 56 datë 1.2.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore".
5. Ndjekja e grafikut të trajnimeve pranë ASPA-s, për 16 punonjës të MAS. Gjatë kësaj periudhe trajnimet kanë vijuar të realizohen online ku nëpunësit janë regjistruar në mënyrë individuale. ASPA ka ofruar Ëëbinare me tematika të ndryshme për të gjithë nëpunësit e MAS bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim të identifikuar nga nevojat e nëpunësve dhe të përmbledhura në kalendarin e trajnimeve 2023.
6. Gjatë periudhës janar-prill 2023 është zhvilluar një procedurë për shkelje disiplinore për **1 nëpunës** në MAS dhe **19 procedura** për punonjës në institucionet e varësisë.
7. Trajtimi i rreth **252 shkresa/kërkesa** të ardhura nga qytetarët dhe nga institucionet qendrore dhe të varësisë.
8. Ndjekja e korrespondencës me ILDKPKI në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për procedurat e deklarimit para fillimit/pas largimit nga funksioni dhe periodik për **18 subjekte** deklaruese (DPV), **1 subjekt** deklarues DPF dhe **1 subjekt** deklarues DPL.
9. Ndjekja e procesit të vlerësimit të nëpunësit civil, për **78 vlerësime** në punë të nëpunësve civilë për periudhën 1 korrik 2022 deri 31 dhjetor 2022.
10. Ndjekja e procesit të hartimit dhe azhornimit të përshkrimeve të punës, për përshkrimet e punës ekzistuese, si edhe për pozicionet e reja të krijuara në strukturën e MAS (*periodike*). Për shkak të ristrukturimit, përgatitja e përshkrimeve të reja të punës, *në proces*;
11. Azhornimi i dosjeve të personelit sipas përcaktimeve të vendimit 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". Krijimi i **12 dosjeve** të nëpunësve të rinj të emëruar gjatë periudhës janar - prill 2023 në MAS.
12. Plotësimi i librezave të punës së punonjësve (e vazhdueshme në bazë të kërkesave të nëpunësve, në rastet e daljes në pension dhe emërimit në institucion).
13. Përgatitja e listëprezencave për çdo muaj gjatë periudhës janar - prill 2023.
14. Ndjekja e grafikut të lejeve vjetore të punonjësve të MAS për periudhën janar - prill 2023, hartimi i urdhrat përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm.

15. Pjesëmarrje në grupe pune, përfaqësim i drejtorisë në mbledhje, takime, përgatitja e informacioneve sipas kërkesave, etj.

**Objektiv 4). Auditimi i 30% dhe inspektimi në 10-12% të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare. Realizimi për periudhën 01 Janar – 30 Prill 2023**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, mbështetur në planin vjetor, të miratuar nga Ministri me nr.6998 prot., datë 24.10.2022, ka përcaktuar objektivat me programe konkrete, për realizimin e misionit të auditimit si:

- Dhënies përparësi për auditim, atyre fushave që janë vlerësuar me rrishtë të mesëm dhe të lartë;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm, në institucionet e audituara, ka kryer vlerësimin sistemit të kontrollit të brendshme dhe nga këto vlerësime vërehet se, këto sisteme janë ngritur dhe janë vlerësuar me nivel mesatar.
- Analiza e programeve të AB, për periudhën raportuese:
- Hartimi i planit vjetor, është bazuar në kapacitetet e planifikuara të burimeve që ka kjo drejtori si dhe në vlerësimin e riskut të institucioneve të varësisë.
- Për periudhën (Janar - Prill) 2023, ishin planifikuar për t'u realizuar 7 auditime në 7 institucione dhe janë realizuar 7 auditime në 7 institucione
- Rekomandimet e propozuara gjithsej 30, nga këto:
- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, gjithsej 6
- Rekomandime të karakterit organizativ, gjithsej 24
- Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, është vlerësuar si një proces i pandërprerë dhe i vazhdueshëm gjatë gjithë veprimtarisë, ku marrin pjesë të gjithë punonjësit e subjektit të audituar, ky vlerësim është bërë sipas këtyre komponentëve:
- Për ambientin e kontrollit të brendshëm;
- Për vlerësimin e riskut;
- Për kontrollin e aktivitetit operacional;
- Për sistemin e informimit dhe të komunikimit;
- Për monitorimin;
- Sistemet e kontrollit të brendshëm për administrimin e aktiveve.
- Prioritetet në vazhdim:
- Përmirësimi i procesit të vlerësimin të riskut, mbi bazën e të cilit të hartohen programet e angazhimit të auditimeve;
- Zgjerimi i aftësive për të kryer auditime mbi bazë risku dhe sistemi;
- Dobishmëria dhe efektiviteti me impakt konkret, në arritjen e objektivave të institucioneve, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për njësitë e audituara.

**Produkteve/ aktiviteteve të realizuara nga Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në vitin 2023, Ju bëjmë me dije si në vijim për veprimtaritë që lidhen me: Integriti evropian:**

**Marrëveshje dhe Memorandume të firmosura dhe në proces negocimi:**

1. Është firmosur më 13 janar 2023 “*Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin Reciprok ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës (Kampusit Bruzh)*”;
2. Është hartuar shtesa e protokollit me Austrinë për zgjatjen e protokollit deri në fund të vitit 2023, si dhe janë marrë komentete e ministrive të linjës mbi rinovimin e “*Protokollit të Mbledhjes IV të Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Austri për bashkëpunim në Fushat e Kulturës, Arsimit dhe Shkencës për vitet 2023-2027*” dhe është përcjellë drejt MEPJ;
3. Është negociuar mbi 2 (dy) marrëveshje në fushën e arsimit me Kinën, për të cilat jemi në pritje të komenteve përfundimtare të Kinës;
4. Është negociuar me MEPJ dhe palën malazeze mbi “*Memorandumin e mirëkuptimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Shtetit të Rinisë dhe Fëmijëve të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Sporteve dhe Rinisë të Republikës së Malit të Zi në fushën e sporteve dhe rinisë*”, i cili u nënshkrua më 27 shkurt 2023, në Podgoricë gjatë G2G;

5. Është përgatitur dosja e plotë për ministren dhe është nënshkruar më 28 mars 2023 “Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Ludwig-Maximilian të Mynihut për mësimdhënien dhe kërkimet shkencor në degën e studimeve të Albanologjisë”;
6. Është përgatitur dosja e plotë për ministren dhe ministritë e linjës dhe është nënshkruar më 16 mars 2023 “Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunim në Fushën e Sportit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Sportit dhe Turizmit të Republikës së Polonisë”;
7. Është përgatitur dosja e plotë për nënshkrimin e “Protokollit të përbashkët për administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për projektin madhor në Albanologji “Enciklopedia shqiptare””, i cili u nënshkrua më 1 mars 2023;
8. Është negociuar dhe përgatitur dosja e plotë për ministren mbi “Memorandumin e Mirëkuptimi ndërmjet MAS dhe Kolegjit të Evropës për përfaqësim në Këshillin Administrativ”, i cili u firmos më 7 qershor 2023;
9. Është koordinuar nevoja për përkthim zyrtar me MD të marrëveshjeve me Kinën dhe CEEPUS IV, është kontraktuar një përkthyes zyrtarë e MD;
10. Është konsultuar programi kulturor me Greqinë me MEPJ dhe është njoftuar UT;
11. Është përcjellë lista e marrëveshjeve ku përfshihet kërkimi shkencor dhe teknologjia, në kuadër të hartimit të kontributit të parë për Raportin e Komisionit 2023;
12. Në kuadër të mbledhjes së radhës të dy qeverive Shqipëri-Kosovë, të planifikuar të mbahet në muajin qershor 2023, DIKMA në koordinim me MEPJ, KM dhe palën kosovare ka hartuar 3 marrëveshje të reja, si dhe ka përfunduar të gjitha procedurat sipas ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në RSH”;
13. Më 14 prill 2023 është firmosur “Programi për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës”;

Në përbërje të grupit të punës që po negocion kontratën mbi termat e referencës të nënshkruara nga MAS, Bashkisë Durrës , Eagle Hills dhe MCFC

## Fondet e programit “Planifikim Menaxhim” 01110,

Fondet e miratuara me ligjin vjetor nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” në programin buxhetor “Planifikim Menaxhim” janë planifikuar në masën 795.9 milion lekë, nga të cilat 740.9 milion lekë janë fonde për shpenzime korente ose 93.1% e fondeve të këtij programi, si dhe 55 milion lekë ose 6.9% janë planifikuar për shpenzime kapitale/ investime.

- Fondet e programit “Planifikim Menaxhim janë në masën 1.6% e fondeve të arsimit, në masën 0.04 ndaj PBB, si dhe ndaj shpenzimeve publike në masën 0.11%.
- Fondet e rishikuara të këtij programi pas rishpërndarjes të fondeve në vitin 2023, janë në masën 795.6 milion lekë ose 1.6 % e fondeve të MAS.

Realizimi për periudhën 4-mujore 2023, është në masën 237.1 milion lekë ose në masën 90% ndaj planit 4-mujor 2023, fondet e realizuara arrijnë në 1.5% të shpenzimeve të realizuara për arsimin. Fondet e realizuara në programin “Planifikim Menaxhim janë në masën 1.6% e fondeve të arsimit, në masën 0.04% ndaj PBB, si dhe ndaj shpenzimeve publike në masën 0.11%.

### a) Fondet për shpenzime personeli për vitin 2023.

Fondet e miratuara në zërin “Pagat dhe sigurimet shoqërore, artikulli 600-601”, për vitin 2023, arrijnë nga 628.6 milion lekë, fondet e rishikuara pas rishpërndarjes me akte normative për vitin 2022, arritën në shumën 630.2 milion lekë. Realizimi për 4-mujorin 2023 është në masën **202.3 milion lekë ose në 90%** ndaj fondit të planifikuar për 4-mujrin 2023.

**Fondet për shpenzime personeli për vitin 2023 kanë mbuluar pagat si dhe sigurimet shoqërore për 671 punonjës** nga të cilët;

- 1) Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për 134 punonjës (pas ndryshimeve të strukturën e miratuar/ ndryshuar për vitin 2022, ky numër është **134 punonjës**)
- 2) Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, **4 drejtori**, si dhe **52 Zyra Vendore Arsimore** me 509 punonjës e specialistë;

3) Agjencia Sigurimit të Cilësisë në Arsimin parauniversitar (ASCAP), ish-Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, për **28 punonjës** (pas ndryshimeve të strukturës e miratuar për 2019).

**b) Fonde për krijimin e kushteve të punës (artikulli 602-605)** për rreth 671 punonjës në Aparatin e MAS si dhe DRAP/ZVAP dhe ASCAP, (ish-DAR/ZA dhe ish-Inspektoriati Shtetëror i Arsimit), për vitin 2023 janë planifikuar **110.2 milion lekë** në vit ose 14.8% e fondeve të miratuara për këtë program.

**Fondet e buxhetit të rishikuar për shpenzime korentë janë në masën 112.5 milion**, ose 15.1% të fondeve të rishikuara për këtë program, ku sipas përparësive janë parashikuar; fonde për të mbuluar shpenzimet për likuidimin detyrimeve për, energji elektrike, telefon, internet, ujë, karburant, udhëtime e dieta, kancelari, materiale deh shërbime të tjera zyre, si dhe të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Shpenzime për trajnimin e punonjësve të MAS, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve etj. Realizimi për 4-mujorin 2023 është në masën 38 milion lekë ose në masën 95%, ndaj fondit të planifikuar për 4-mujorin 2022.

**c) Fondet për shpenzime kapitale për vitin 2023:**

**Fondet për shpenzime kapitale për vitin 2023, janë miratuar 55 milion lekë**, ose 6.9% e fondeve të këtij programi. Synim kryesor është përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve të infrastrukturës me qëllim përmirësimin e kushteve të punonjësve në institucione arsimore ku përfshihen katër DRAP Zyrtarë Vendore Arsimore, ASCAP, si dhe Aparati i MAS. Burimi financimit për investimet kapitale vitin 2022 është në masën 100% nga buxheti i shtetit.

Pas rishikimit me akte normative në vitin 2023 në këtë program për shpenzime kapitale janë në masën **55 milion lekë, realizimi për vitin 2023** është në masën 1 milion leke ose 87% e fondeve të miratuara për 4 mujorin 2023, vijnë procedurat e prokurimit publike dhe realizimin e kontratat për produktet parashikuara për vitin 2023.

**c.1 Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese janë 41.5 milion lekë, fondet e rishikuara janë në masën 11.5 milion lekë**, këto fondet janë detajuar sipas projekteve për institucionet vendore arsimore janë duke u ristrukturuar ” *Rikonstruksion i mjediseve të DRAP Korce, ZVA Peqin dhe ZVA Kucove*”, në zbatim të Vendim nr. 99, datë 27.2.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

Realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën 4-mujore është në masën 1 milion lekë, janë realizuar duke u realizuar procedurat e prokurimit **c.2 Fondet e parashikuara për blerje pajisje orendi ”Pajisje të ndryshme - Aparati MAS”** në shumën prej 10 milion lekë, procedurë prokurimi të përqëndruar tek Ministria e Brendshme, janë duke u realizuar procedurat e prokurimit.

**c.3 Fondet e parashikuara për blerje pajisje orendi ” Blerje pajisje elektronike dhe softë informatike për shërbimet në MAS, DRAP/ZVA”** në shumën prej 3.5 milion lekë, **fondet e rishikuara janë në masën 3.5 milion lekë**, janë realizuar duke u realizuar procedurat e prokurimit nga AKSHI.

**Realizimi i fondeve për periudhën 4-mujore 2023**, në këtë program është në MASR në masën **98%** dhe përfaqëson rreth 1.6% të totalit të shpenzimeve të realizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për 2022, sipas zërave kryesore.


Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korentë **90%**

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale **87%**

**Gjithsej **90%****

**Tabela nr. 1\_(01110 PM) Fondet e realizuara në vitin 2021-2022, fondet e planifikuara PBA 2023, fondet e miratuara në ligjin vjetor 2023 fondet e rishikuara për vitin 2023, si dhe dhe fondet e realizuara për 4-mujorin e vitit 2023, në 000 lekë dhe në %.**

NEKSI Nr.2											
Tabela S: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për Buxhetin 2023 (cdo 4 mujor progresive)											
		ne 000 leke		ne 000 leke		4-Mujori 2023		ne 000 leke			
Ministria	MINISTRIA E ARSIMIT dhe SPORTIT									Kodi	11
Programi	Planifikim Menaxhim									Titulli	01110
Totali Shpenzimeve											
Artikulli	6	6	2	3	4	5	6	(7)=(6)-(5)			
Kodi	Emri	Fakti 12-Mujor	Fakti 12 Mujor	PBA	Buxheti	Buxheti rishikuar	Buxheti periodues	Fakti 4 Mujor 2023	Diferenca	Realizim ne % ndaj planit 4-mujor 2023	
600	Paga	489,765.7	490,010.6	507,120.0	535,768.0	535,768.0	192,876.5	173,565.2	19,311.2	90%	32.4%
601	Sigurime Shogjore	82,376.8	81,880.2	90,180.0	94,411.0	94,411.0	33,988.0	28,731.3	5,256.7	85%	30.4%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	85,618.8	81,545.5	110,700.0	109,980.0	109,980.0	35,193.6	33,216.3	1,977.3	94%	
603	Subvencione			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
604	Transferata Korente të Brendshme			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
605	Transferata Korente të Huaja	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0%	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,052.3	11,790.1	720.0	720.0	2,561.4	922.1	567.3	354.8	62%	
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>660,813.7</b>	<b>665,226.4</b>	<b>708,720.0</b>	<b>740,879.0</b>	<b>742,720.4</b>	<b>262,980.1</b>	<b>236,080.0</b>	<b>26,900.1</b>	<b>90%</b>	
230	Kapitale të Patrupezuara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
231	Kapitale të Trupezuara	63,608.5	63,549.7	55,000.0	55,000.0	55,000.0	1,100.0	958.9	141.1	87%	
232	Tranferta kapitale										
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale fin Brenc</b>	<b>63,608.5</b>	<b>63,549.7</b>	<b>55,000.0</b>	<b>55,000.0</b>	<b>55,000.0</b>	<b>1,100.0</b>	<b>958.9</b>	<b>141.1</b>	<b>87%</b>	
230	Kapitale të Patrupezuara										
231	Kapitale të Trupezuara										
232	Tranferta kapitale										
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale fin Huaj</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b></b>	<b></b>
<b>Totali</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>724,422.2</b>	<b>728,776.1</b>	<b>763,720.0</b>	<b>795,879.0</b>	<b>797,720.4</b>	<b>264,080.1</b>	<b>237,038.9</b>	<b>27,041.2</b>	<b>90%</b>	<b>0%</b>
										6.911%	
<b>hte Buxhetore</b>										<b>0.0</b>	<b>#DIV/0!</b>
<b>kapitale + jashte buxhetore)</b>										<b>727,870.0</b>	<b>729,658.8</b>
<b>Ndaj PBB ne %</b>										<b>0.04%</b>	<b>0.04%</b>
<b>Shpenzimet Totale te konsolida</b>										<b>0.12%</b>	<b>0.11%</b>



## Faktorë që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 4-mujorin vitin 2023;

- Shpenzimet e personelit janë realizuar në masën 90%**, pasi nuk është plotësuar numri i miratuar i punonjësve sipas strukturave të miratuara për vitin 2023, pas ristrukturimit dhe plotësimi i numrit të punonjësve të miratuar për ZVAP, në zbatim të Vendimit nr. 99, datë 27.2.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, si dhe Vendimit nr. 98, datë 27.2.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).
- Procedurave të prokurimit publik**, miratuar Agjencia e Prokurimit Publik, për blerje pajisje elektronike dhe softë informatike per sherbimet ne MAS, DRAP/ZVA”.
- Nuk janë realizuar fondet e miratuara në rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese janë 41.5 milion lekë**, këto fondet janë detajuar sipas projekteve për institucionet vendore arsimore janë duke u ristruktuaruar **vijojnë procedurat konform ligjit Prokurimit Publik “Rikonstruksion i mjediseve te DRAP Korce, ZVA Peqin dhe ZVA Kucove”**,.

## II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushtetë barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar. Arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane. Rritja e aksesit në AP, përfshirja e 100% e fëmijëve 5 vjeçare në klasat përgatitore; Rritja e viteve të shkollimit. Rritja e autonomise se shkollave; Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në AB, Tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në AB. Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve. Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB, Shtrirja e shërbimit të punonjesit social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara.

Ndër objektivat dhe produktet/ aktivitetet/ shërbimet që janë financuar me përparësi, në këtë grup shpenzimesh për vitin 2023, janë sa vijon;

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)**, është i vetmi institucion në RSH që kontrollon dhe vlerëson cilësinë në arsimin e lartë. Kjo, duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë. ASCAL është i pavarur, i paanshëm dhe transparent në kryerjen e veprimtarisë së tij. ASCAL kryen vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit në IAL publike dhe private në Shqipëri. Gjithashtu Agjencia kryen vlerësime analitike dhe krahasuese për IAL, programet dhe fushat e studimit. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes vlerësimit të jashtëm, objektiv dhe të pavarur; Ruajtja e standardeve të cilësisë; Promovimi dhe përmirësimi i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë.

#### **Qendra e Shërbimeve Arsimore, Tiranë ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I FONDEVE BUXHETORE:**

Në zbatim të VKM-së nr.1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar, buxhetit të miratuar me ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe VKM nr.560, datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”, fondet e buxhetit të miratuara, për institucionin tonë për vitin ushtrimor 2023 si dhe Të Ardhurat e trashëguara nga viti 2022 dhe të arkëtuara gjatë 4 mujorit janar – prill 2023, janë në shumën 109.083.290 lekë, të detajuara sipas programeve të miratuara paraqiten si më poshtë:

1. Programi “Arsimi i Lartë”. Kapitulli (6).... 74.083.290 lekë
2. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”. Kapitulli (1).... 25.000.000 lekë
3. Programi “Arsimi i Bazë”. Kapitulli (1).... 10.000.000 lekë

Qendra e Shërbimeve Arsimore gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2023, administroi dhe menaxhoi fondet buxhetore, sipas programit të miratuar, si më poshtë:

- |  |                 |
|--|-----------------|
| 1. Programi “Arsimi i Lartë”. Kapitulli (6)....                | 74.083.290 lekë |
| 2. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”. Kapitulli (1).... | 12.600.000 lekë |

**Fondet e miratuara/autorizuara për përdorim gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2023 për QSHA, në Programin 09450 “Arsimi i Lartë”, janë në shumën 25.756.489 lekë, sipas grup artikujve janë sa vijon:**

Fondet për shpenzimet korente kapitulli (6) ku përfshihen fondet për shpenzime personeli, fondet për shpenzime për blerje materiale dhe shërbime, si dhe fondet për investime arrijnë në kuotën 19.864.854 lekë ose 77.12 % të fondeve/Të Ardhurave të trashëguara nga viti 2022 dhe arkëtuara gjatë vitit ushtrimor 2023 ose 51.79% e fondeve të planifikuara për përdorim gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2023.

- Fonde për shpenzime për personelin për 4 mujorit të parë të vitit 2023;** janë planifikuar në shumën 18.662.413 lekë, e cila garantoi mbulimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të numrin aktual të punonjësve të institucionit prej 44 punonjës për 4 mujorit të parë të vitit 2023. Shpenzimet e personelit të miratuar për 4 mujorit të parë të vitit 2023 zënë rreth 72.45% e Të Ardhurave të autorizuara të institucionit. Këto fonde janë realizuar në shumën 12.403.080 lekë ose në masën 66.46%, e Të Ardhurave të caktuara për këtë qëllim.
- Fondet për shpenzimet korente/operative për blerje mallra dhe shërbime;** Fondet e miratuara për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga të tretë janë planifikuar në shumën 6.970.596 lekë ose 27.06% e Të Ardhurave të autorizuara të institucionit. Zërat kryesorë në këtë grup artikull të shpenzimeve të tjera korente janë, shpenzimet për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për realizimin e detyrave institucionale, shpenzimet për ruajtjen e institucionit, energji elektrike, ujë, telefon, posta etj. Këto fonde janë realizuar në shumën 6.960.194 lekë ose në masën 99.85% e Të Ardhurave të caktuara për këtë qëllim.
- Fondet për shpenzimet korente/kapitale;** Fondet e miratuara për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e pajisjeve kompjuterike nga të tretë janë planifikuar në shumën 123.480 lekë ose 0.48% e Të Ardhurave të autorizuara të institucionit. Këto fonde janë realizuar në shumën 0 lekë, ose në masën 0% e Të Ardhurave të caktuara për këtë qëllim
- Fondet të pacaktuara për shpenzimet;** Fondet të arkëtuara gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2023, gjendje në Thesar, të pacaktuara mbulimin e shpenzimeve institucionale për vitin 2023 janë në shumën 48.326.880 lekë ose 85.04% e Të Ardhurave të krijuara.

**Fondet e miratuara për QSHA në Programin 09230 “Arsimi i Mesëm i përgjithshëm”, sipas grup artikujve janë sa vijon:** Fondet për shpenzimet korente kapitulli (1) ku përfshihen fondet për shpenzime për blerje materiale dhe shërbime arrijnë në kuotën 12.600.000 lekë ose 36.0 % të fondeve të miratuara për vitin 2023.

**Fondet për shpenzimet korente/operative për blerje mallra dhe shërbime;** Fondet e miratuar për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga të tretë ishin planifikuar në shumën 12.600.000 lekë. Këto fonde janë realizuar në shumën 1.503.707 lekë, ose 11.93 % e tyre, dhe janë shpenzuar për të likuiduar detyrime të prapambetura të vitit 2022, përkatësisht tatim i mbajtur në burim, për muajin dhjetor, si dhe pagesa për honorarë për të drejtën e autorit, për bashkëpunëtorët e Drejtorisë së Vlerësimeve, autorë të hartimit të fondit të pyetjeve për testimin e informatizuar të mjekësisë, si dhe anëtarët e komisionit certifikimit të tyre.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4 mujorin e parë të vitit 2023 rezulton si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime për personelin, kap.6	66.46 %
Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente/operative, kap 6	99.85 %
Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente/kapitale, kap 6	0.00 %
<u>Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente/operative, kap.1</u>	<u>11.93 %</u>
Realizimi i fondeve buxhetore total	<b>54.40 %</b>

Nr	Emri i programit	Buxheti i miratuar 4 mujori 2023		Realizimi 4 mujor 2023		
		Në mijë /lekë	Në %	Në mijë /lekë	Në % ndaj planit	Struktura në % ndaj realizimit
1	Arsimi i lartë kapitulli 6	25,756.5	67.2	19,363.3	75.2	92.8
2	Arsimi i mesëm i përgjithshëm kapitulli 1	12,600.0	32.8	1,503.7	11.9	7.2
	<b>Totali</b>	<b>38,356.5</b>	<b>100.0</b>	<b>20,867.0</b>	<b>54.4</b>	<b>100.0</b>

**Zhvillimi dhe Administrimi, Provimeve të Shtetit dhe aktivitetet vjetore të parashikuara për vitin 2023.**

- Zhvillimi dhe administrimi i Provimeve të Shtetit në profesionin e rregulluar të Mjekut,** Stomatologut, Farmacistit, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Logopedistit, Teknikut të Imazherisë, Teknikut të Laboratorit.
- Zhvillimi dhe administrimi i Provimeve të Shtetit në profesionin e rregulluar të Mësuesit në profilet:** Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Gjuhë Angleze, Gjuhë Italiane, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Frënge, Arsim Fillor,

Arsim Special, Shkenca Sociale, Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Histori Gjeografi, Histori Gjeografi Edukatë, Matematikë Fizikë, Matematikë Informatikë, Kimi Biologji, Edukim Fizik, Arte Figurative, Instrumente Muzikore, Gjuhë Greke.

3. **Zhvillimi dhe administrimi i Provimit të shtetit për Psikolog në profilet:** Psikologji Edukimi Shkollore, Psikologji Klinike, Psikologji Ligjore, Psikologji Organizacionale dhe Psikologji Sociale/Komunitare.
4. **Zhvillimi dhe administrimi i provimit të shtetit për Veteriner.**
5. **Zhvillimi dhe administrimi i testimit të informatizuar të mësuesve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit para universitar, në profilet:** Arsim Fillor, **Arsim Parashkollor**, Arsim Special, Art Pamor, Art Pamor (Shkolla Artistike), Balet (Shkolla Artistike), Biologji, Edukim Fizik, Fizikë, Gjeografi, Gjuhë Angleze, Gjuhë Frënge, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Greke, Gjuhë Italiane, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Histori, Kimi, Matematikë, Muzikë, Muzikë (Shkolla Artistike), Shkenca Sociale, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi dhe Ekonomi.
6. **Zhvillimi dhe administrimi provimit të digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore në profesionet:** Infermieri, Mami, Fizioterapi, Logopedi, Teknik Imazherie dhe Teknik Laboratori.
7. **Zhvillimi dhe administrimi i provimit të specializimeve afatgjata të ciklit të tretë në Mjekësi dhe Stomatologji.**
8. Përcjellja e rezultateve përfundimtare të provimit të shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara pranë Ministrive, Urdhrave Profesionale, Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe DPAP.
9. Përgatitja e Licencave të kandidatëve të suksesshëm në profilet e mësuesisë për Sezonin XVII Prill – Maj 2022. Administrimi i dorëzimit dhe shpërndarjes së tyre nëpërmjet DRAP.
10. Përditësimi, organizimi dhe digjitalizimi i fondeve të pyetjeve. Digjitalizimi i programeve orientuese dhe fondeve të reja të pyetjeve të provimit të shtetit. Përditësimi i fondeve të pyetjeve në server në bazë të procesverbaleve të Komisioneve të provimit të shtetit për çdo profesion/profil. Publikimi në faqen zyrtare i programeve orientuese dhe fondeve të pyetjeve pa përgjigjet e sakta.
11. Ndjekja e praktikave dhe korrespondencave institucionale.
12. Krijimi dhe administrimi i të gjithë dokumentacionit shkresor (procesverbale, vendime komisioni, korrespondenca, etj.) që lidhen me procedurat e ndjekura gjatë organizimit dhe zhvillimit të provimeve të shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara.
13. Krijimi, arkivimi, përditësimi dhe administrimi i bazës elektronike të të dhënave dhe rezultateve të kandidatëve të regjistruar për pjesëmarrje në provimin e shtetit për të gjitha sezonet e zhvilluara.
14. Kryerja e analizave statistikore që lidhen me provimet e shtetit dhe provimet e digjitalizuara, që i shërbejnë rritjes së cilësisë në arsim.

**Për objektivin 1: Zhvillimi dhe administrimi i Provimit të Shtetit për sezonin XXIII Mjekësi, Janar – Shkurt 2023 në profesionin e rregulluar të: Mjekut, Farmacistit, Stomatologut, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Teknikut të Imazherisë, Teknikut të Laboratorit dhe Logopedistit. Kalueshmëria sipas pjesëmarrjes**

Nr.	Profili	Të regjistruar	Pjesëmarrës	% Pjesëmarrës	Të suksesshëm	% Të suksesshëm	Të pasuksesshëm	% Të pasuksesshëm	Munguar	% Munguar
1	Farmaci	174	157	90.23%	103	65.61%	54	34.39%	17	9.77%
2	Fizioterapi	188	140	74.47%	96	68.57%	44	31.43%	48	25.53%
3	Infermieri	1728	1302	75.35%	957	73.50%	342	26.27%	426	24.65%
4	Logopedi	50	22	44.00%	16	72.73%	6	27.27%	28	56.00%
5	Mami	372	217	58.33%	149	68.66%	68	31.34%	155	41.67%
6	Mjekësi	222	213	95.95%	194	91.08%	19	8.92%	9	4.05%
7	Stomatologji	203	182	89.66%	139	76.37%	43	23.63%	21	10.34%
8	Teknik Imazherie	158	122	77.22%	49	40.16%	73	59.84%	36	22.78%
9	Teknik Laboratori	182	156	85.71%	114	73.08%	42	26.92%	26	14.29%
	<b>Gjithsej</b>	<b>3277</b>	<b>2511</b>	<b>76.62%</b>	<b>1817</b>	<b>72.36%</b>	<b>691</b>	<b>27.52%</b>	<b>766</b>	<b>23.38%</b>

Kalueshmëria sipas notave

N	Profili	Pjesëm arrja	Nota 4	4%	5	5%	6	6%	7	7%	8	8%	9	9%	10	10%	Nota mesat
1	Farmaci	157	54	34.39%	11	7.01%	27	17.20%	23	14.65%	22	14.01%	12	7.64%	8	5.10%	6.10
2	Fizioterapi	140	44	31.43%	8	5.71%	35	25.00%	20	14.29%	9	6.43%	21	15.00%	3	2.14%	6.12
3	Infermieri	1302	345	26.27%	89	6.84%	222	17.05%	223	17.13%	236	18.13%	166	12.75%	21	1.61%	6.37
4	Logopedi	22	6	27.27%	4	18.18%	7	31.82%	2	9.09%	3	13.64%	0	0.00%	0	0.00%	5.64
5	Mami	217	68	31.34%	29	13.36%	51	23.50%	44	20.28%	20	9.22%	5	2.30%	0	0.00%	5.70
6	Mjekësi	213	19	8.92%	5	2.35%	12	5.63%	21	9.86%	26	12.21%	64	30.05%	66	30.99%	8.28
7	Stomatologji	182	43	23.63%	12	6.59%	30	16.48%	35	19.23%	32	17.58%	24	13.19%	6	3.30%	6.53
8	Teknik Imazherie	122	73	59.84%	14	11.48%	20	16.39%	13	10.66%	2	1.64%	0	0.00%	0	0.00%	4.83
9	Teknik Labora	156	42	26.92%	10	6.41%	32	20.51%	30	19.23%	34	21.79%	8	5.13%	0	0.00%	6.18
	Gjithsej	2511	691	27.52%	182	7.25%	436	17.36%	411	16.37%	384	15.29%	300	11.95%	104	4.14%	6.36

### Kalueshmëria dhe pjesëmarrja për kandidatët e herës së parë

Nr.	Profili	Të regjistruar	Pjesëmarrës	Hera 1 Regjistruar	Hera 1 Pjesëmarrës	Të suksesshëm Hera 1	% Të suksesshëm Hera 1
1	Farmaci	174	157	124	120	81	67.50%
2	Fizioterapi	188	140	136	112	85	75.89%
3	Infermieri	1728	1302	1146	960	774	80.63%
4	Logopedi	50	22	31	13	11	85%
5	Mami	372	217	183	125	99	79.20%
6	Mjekësi	222	213	206	201	189	94%
7	Stomatologji	203	182	176	164	133	81.10%
8	Teknik Imazherie	158	122	88	73	38	52.05%
9	Teknik Laboratori	182	156	116	108	93	86.11%
	Gjithsej	3277	2511	2206	1876	1503	80.12%

**Për objektivin 2:** Zhvillimi dhe administrimi i provimit të Specializimeve Afatgjata në fushat e Mjekësisë dhe Stomatologjisë, Mars 2023

Nr.	Profili	Të Regjistruar	Pjesëmarrës	Munguar	Skualifikuar	Pikë Maksimale (100)
1	Specializime Mjekësi	345	332	12	1	24
2	Specializime Stomatologji	54	53	1	0	11
	<b>Totali</b>	<b>399</b>	<b>385</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	

**Për objektivin 3:** Zhvillimi dhe administrimi i Provimit të Shtetit për sezonin XVIII, Prill – Maj 2023, në profesionin e rregulluar të Mësuesit në profilet: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Gjuhë Angleze, Gjuhë Italiane, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Frënge, Arsim Fillor, Arsim Special, Shkenca Sociale, Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Histori Gjeografi, Histori Gjeografi Edukatë, Matematikë Fizikë, Matematikë Informatikë, Kimi Biologji, Edukim Fizik, Arte Figurative, Instrumente Muzikore, Gjuhë Greke.

Për sezonin XVIII të provimit të shtetit në profilet e profesionit të rregulluar të Mësuesit, të zhvilluar gjatë periudhës Prill – Maj 2023, arrijtjet e detajuara do të paraqiten gjatë raporteve të mëvonshme, duke qenë se sezoni nuk ka përfunduar dhe përpunimi i të dhënave është ende në proces.

**Për objektivin 4:** Përcjellja e rezultateve përfundimtare të provimit të shtetit për sezonin XXIII Mjekësi dhe Provimit të Specializimeve Afatgjata të ciklit të tretë në fushat e Mjekësisë dhe Stomatologjisë.

Përcjellja brenda afateve ligjore të rezultateve të provimit të shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara pranë Ministrive, Urdhrave Profesionalë, Universitetit të Mjekësisë dhe Komisioneve të Vlerësimit.

Konkretisht rezultatet janë dërguar pranë MAS, MSHMS, Urdhrit të Mjekut, Urdhrit të Farmacistit, Urdhrit të Stomatologut, Urdhrit të Infermierit, Universitetit të Mjekësisë dhe Komisioneve të Vlerësimit.

**Për objektivin 5:** Digjitalizimi i fondeve të reja të pyetjeve. Publikimi në fazën zyrtare të QSHA, i programeve orientuese dhe fondeve të reja të pyetjeve. Rishikimi i fondeve ekzistuese. Publikimi në faqen zyrtare të QSHA, i fondeve të rishikuara të pyetjeve dhe përditësimi i tyre në sistemin e provimit të shtetit. Përditësimi i fondeve të pyetjeve bazuar mbi procesverbalet dhe vendimet e nënshkuara nga Komisionet e Provimit të Shtetit dhe Komisionet e Vlerësimit.

- Digjitalizimi i fondit të pyetjeve të maturantëve, në kuadër të pranimit në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. (3003 pyetje në total)

- Publikimi në faqen zyrtare i fondit të pyetjeve të maturantëve, në kuadër të pranimit në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

- **Rishikimi i fondit të pyetjeve të programit të përbashkët në 24 profilet e Mësuesisë.**

- **Përditësimi në sistemin e Provimit të Shtetit i fondit të rishikuar të pyetjeve të programit të përbashkët në 24 profilet e profesionit të rregulluar të Mësuesit:** Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Gjuhë Angleze, Gjuhë Italiane, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Frënge, Arsim Fillor, Arsim Special, Shkenca Sociale, Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Histori Gjeografi, Histori Gjeografi Edukatë,

Matematikë Fizikë, Matematikë Informatikë, Kimi Biologji, Edukim Fizik, Arte Figurative, Instrumente Muzikore dhe Gjuhë Greke.

- **Përditësimi në faqen zyrtare i pyetjeve të rishikuara të programit të përbashkët përditësimin e fondit të rishikuar të pyetjeve të programit të përbashkët në 24 fondet e pyetjeve të profileve të profesionit të rregulluar të Mësuesit:** Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Gjuhë Angleze, Gjuhë Italiane, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Frënge, Arsim Fillor, Arsim Special, Shkenca Sociale, Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Histori Gjeografi, Histori Gjeografi Edukatë, Matematikë Fizikë, Matematikë Informatikë, Kimi Biologji, Edukim Fizik, Arte Figurative, Instrumente Muzikore dhe Gjuhë Greke.

- **Përditësimi në sistemin e Provimit të Shtetit i fondit të pyetjeve të Stomatologut, Farmacistit, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Teknikut të Imazherisë, Teknikut të Labororit dhe Logopedistit dhe Specializimeve Mjekësi e Stomatologji, bazuar mbi procesverbalet dhe Vendimet e Komisionit, të nënshkruara nga Komisionet e Provimit të Shtetit dhe Komisionet e Vlerësimit.**

**Për objektivin 6:** Krijimi i bazës shtetërore të të dhënave për kandidatët pjesëmarrës në provimet e zhvilluara gjatë periudhës Janar – Prill 2023 dhe bazës shtetërore të fondeve të pyetjeve të Provimit të Shtetit dhe provimeve të digjitalizuara. Marrja e masave për zbatimin e protokolleve të sigurisë e tyre.

**Objektiv 4) Përmirësimi i standardeve infrastrukurore duke rritur raportin sipërfaqe/student së paku me 1m<sup>2</sup>/ student dhe vende për punë dhe kërkim në laboratore e biblioteka.**

- **Fonde në formë gradi për zhvillim, për financimin e investimeve në shumën prej 1 miliard 180 milion lekë,** nga të cilat 880 milion lekë janë me burim financimin nga buxheti i shtetit dhe 300 milion lekë janë me burim nga projekte financim u huaj.
- **Fondet nga të ardhurat e IAL publike të destinuara për investime kapitale,** projekte për vitin 2023 arritën 666.2 milion lekë, realizimi është në masën 495.2 milion leke ose 74%.
- **Pra në total për 4-mujorin 2023,** me financim nga fondet me burim financim buxhetin e shtetit “**formë gradi për zhvillim**”, si dhe nga të ardhurat e IAL publike të destinuara për investime kapitale , projekte për vitin 2023 arritën 1 miliard 625.1 milion lekë dhe realizimi është në masën 274 milion lekë, ose në masën 60% e fondi vjetor ose 60% e fondit të parashikuar për periudhën 4-mujore 2023.
- **Fondet grant për financimin e projekteve me financim u huaj,** për vitin 2023, arritën në shumën 300 milion lekë janë , realizimi është në masën 8 milion lekë ose 3%, prej nga janë financuar 82 projekte.

**Financimin e veprimtarisë së IAL publike për vitin 2023 (programi buxhetor 09450),** janë planifikuar fonde me burim financimi buxhetin e shtetit në shumën prej **11.58 miliard lekë,** nga të cilat 10.4 miliard lekë janë në grupin e shpenzimeve korente “granti i mësimdhënies”, si dhe 1 miliard e 2180 milion lekë janë në grupin e shpenzimeve kapitale.

**Shpërndarja e fonde me burim financimi buxhetin e shtetit në financimin e institucioneve të arsimit të lartë** do të realizohet në përputhje me kërkesat nenit 7 pika c, neni 108, 110, 111,112 dhe 113 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në formë grant, si dhe kriterëve të përcaktuar në VKM nr.75, datë 12.2.2018.

Fondet e miratuara në formë “**grant për mësimdhënie**” për vitin 2023, janë në masën 10.4 miliard lekë, **këto fonde rishpërndahen** sipas kriterëve të përcaktuar në VKM nr.75, datë 12.2.2018, ku përfshihen fondet për mbulimin e shpenzimeve të personelit “Granti për mësimdhënie”, **në shumën 9 miliard lekë 53 milion lekë,** fondet për bursa financiare për studentët në shumën **prej 1 miliard 31 milion lekë,** mbështetje financiare për shoqëritë e **studntëve 300 milion lekë,** si dhe fonde grand për akreditim institucional të IAL si dhe të programeve të studimi ASCAL në shumën prej **15 milion lekë në vit.**

- **Fondeve grant për IAL publike për vitin 2023, pjesa e shpenzime korente,** është planifikuar 10 miliard e 400 milion lekë, pas rimarrjes së fondeve grant të trashëguara nga viti 2022, fondet për IAL publike arritën në masën 11 miliard 938 milion lekë, janë kryesisht shpenzime personeli për IAL publike, **realizimi 4-mujor 2023 është në masën 3 miliard 237 milion ose në masën 85% fondeve të planifikuara/rishikuara për 4-mujorin 2023,** nga të cilat sipas natyrës së përdorimit janë;

- e. **Shpenzimet nga fondet grant për shpenzime personeli** si dhe shërbime të tjera të domosdoshme, për sigurimin cilësisë në arsimin e lartë, janë miratuar në masën 9 miliard e 259 milion lekë, fondet e realizuara për periudhën 4-mujore 2022, janë në masën 7 miliard e 882 milion leke ose në masën 87%. **Së bashku me të ardhurat këto shpenzime arrijnë në masën 11 miliardë 459.6 milion lekë, fondet realizuara së bashku me të ardhurat 10 miliardë 82 milion lekë, realizimi i tyre është në masën 88%.**
- f. **Shpenzimet për mbulimin e bursave financiare për studentët në kuadrin e “Paktit për Universitet”,** me rreth 1 miliard 31 milion lekë, buxheti i rishikuar 2022, pas rimarrjes së fondeve të kursyera nga viti 2021, është në masën 1 miliard e 287 milion lekë ku përfitues parashikohen të jenë 11 800 studentë, realizimi për periudhën 4-mujorit 2023 është në masën 474.2 milion lekë ose 92% ndaj planit 4-mujorit 2023.
- Ky fond u jep mundësinë rreth 11,800 studentëve për të ndjekur studimet** në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, kategori të caktuara të studentëve sipas rezultateve dhe studentëve nga kategoritë sociale në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të përballuar një pjesë të kostos të studimeve kostot e shkollimit, sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar.
- g. **Fonde grant, për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e studentëve** në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe”, për vitin 2023 janë parashikuar ku parashikohet të akomodohet rreth 6 mijë studentë, janë planifikuar 300 milion lekë në vit, realizimi është në masën 100.6 milion lekë ose në masën 100% e fondit të parashikuar për 4-mujorin parë 2023.
- h. Fonde grant për akreditim institucional si dhe të programeve të studimi ASCAL në shumën prej 15 milion lekë në vit, këto fonde parashikohet të realizohen në 4-mujorin tretë 2023.

**Fonde në formë gradi për zhvillim, për financimin e investimeve në shumën prej 1 miliard e 180 milion lekë** janë në grupin e shpenzimeve kapitale, nga të cilat 880 milion lekë janë me burim financimin nga buxheti i shtetit dhe 300 milion lekë janë me burim nga projekte financim u huaj.

**Fondet e rishikuara për vitin 2023** me burim financim buxhetin e shtetit “formë gradi për zhvillim”, si dhe fonde grant të trashëguara nga kursimet e vitit 2023, arritën në shumën 1 miliard e 425 milion lekë, realizimi për 4-mujorin 2023 është në masën 266.4 milion lekë ose në masën prej 43%.


- l. **Fondet grant për investime nga buxheti i shtetit së bashku me të ardhurat dytësore të IAL publike** për periudhën 4-mujore 2023 arritën në shumën prej 13 miliard 714.7 milion lekë, realizimi është në masën 78% e fondeve të rishikuara për vitin 2023.
- m. **Në total për vitin 2023, fondet të destinuar për investime kapitale në IAL publike,** fondet me burim financim buxhetin e shtetit “formë gradi për zhvillim”, si dhe nga të ardhurat e IAL publike të destinuar për investime kapitale, arritën 1 miliard e 425.1 milion lekë dhe realizimi për 4-mujorin 2023 është në masën 266.4 milion lekë, ose në masën 43% e fondeve të 4-mujorit vitit 2023.
- n. **Fondet me Financim të Huaj plani fillesatar 2023,** është 300 milion lekë realizimi ose 6.5% e fondeve të miratuara për investime për vitin 2023, ku janë duke implementuar 50 projekte me financim të huaj në programin e arsimit të lartë, plani i rishikuar për vitin 2023 është 300 milion lekë, realizimi për periudhën 4-mujore 2023 është në masën 23.4 milion lekë ose 8% e planit vjetor 2023.

**Fondet e fondet e miratuara, për vitin 2023, si dhe dhe realizuara për 4-mujorin 2023;**



NEKSI Nr.2										
Tabela 5: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për Buxhetin 2022 (cdo 4 mujor progresive)										
		ne 000 lekë		ne 000 lekë		12- Mujori 2022		ne 000 lekë		
Ministria	MINISTRIA E ARSIMIT dhe SPORTIT					Kodi	11			
Programi	Arsimi I Larte					Titulli	09450			
Totali Shpenzimeve										
Artikulli	6	6	2	3	4	5	6	(7)-(6)-(5)	Realizim ne % ndaj planit 4- mujor 2023	
Kodi	Entri	2021	2022	2023	2023	2023	2023	2023	2023	
600	Paga	5,903,301	5,979,154.6			7,506,647	2,402,127.1	2,092,305.0	309,822	87%
601	Sqarime Shoqërore	921,417	941,190.8			1,188,065	380,180.9	339,274.1	40,907	89%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	791,559	958,598.6			1,636,855	392,845.1	231,061.8	161,783	59%
603	Subvencione	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0%
604	Transferta Korente të Brendshme	299,900	249,920	10,000,000.0	10,400,000.0	315,000	100,800.0	100,600	200	100%
605	Transferta Korente të Huaja	948.8	3,335.1	0.0	0	4,773	1,145.6	441.6	704	39%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	990,990	952,548	0.0	0	1,287,554	515,021.7	474,159	40,862	92%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	8,907,916	9,084,748	10,000,000	10,400,000	11,938,895	3,792,120	3,237,842	554,279	85%
230	Kapitale të Patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0%
231	Kapitale të Trupezuara	157,309	155,399	1,006,000	880,000	880,000	70,400	63,461	6,939	90%
232	Transferta kapitale			0	0	0	0	0	0	0%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale fin Brend	157,309	155,399	1,130,000	880,000	880,000	70,400	63,461	6,939	90%
230	Kapitale të Patrupezuara	46,870	96,930	0	0	0	0	0	0	#DIV/0!
231	Kapitale të Trupezuara	76,683	18,938	200,000	300,000	300,000	50,000	7,961	42,039	16%
232	Transferta kapitale									0%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale fin Huaj	123,553	115,868	200,000	300,000	300,000	50,000	7,961	42,039	3%
		280,862	271,267			1,180,000	1,180,000	120,400	71,422	59%
Totali	Korrente dhe Kapitale	9,188,778	9,356,014	11,330,000	11,580,000	13,118,895	3,912,520	3,309,264	603,256	85%
600	Paga kapitulli 06	686,133.6	807,486.0	0.0	0.0	72,169.1	72,169.1	72,169.1	0.0	100%
601	Sqarime Shoqërore, kapitulli 06	29,656.7	68,112.2	0.0	0.0	15,722.3	15,722.3	15,722.3	0.0	100%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera, kap	534,161.6	636,592.7	0.0	0.0	251,448.3	251,448.3	157,859.9	93,588.4	63%
603	Subvencione, kapitulli 06	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0%
604	Transferta Korente të Brendshme,	573,639.8	427,838.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0%
605	Transferta Korente të Huajakapit	5,182.5	9,774.8	0.0	0.0	7,689.1	7,689.1	7,689.1	0.0	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ k	21,299.3	59,859.2	0.0	0.0	3,744.3	3,744.3	3,744.3	0.0	100%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,850,073.5	2,009,663.0	0.0	0.0	350,773.1	350,773.1	257,184.7	93,588.4	73%
230	Kapitale të Patrupezuara	10,644	63,655.1	0.0	0.0	15,915.9	15,915.9	6,469.4	9,446.6	41%
231	Kapitale të Trupezuara	697,610	827,851.7	0.0	0.0	529,161.9	529,161.9	196,497.6	332,664.3	37%
232	Transferta kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0%
Nen-Totali	Shpenz Kapitale jashte buxhet	708,254	891,507	-	-	545,078	545,078	202,967	342,111	37%
Kapitale Jashte Buxhetore		2,558,327.8	2,901,169.8	0.0	0.0	895,850.9	895,850.9	460,151.6	435,699.3	51%
Numri i stud/2017-2018 =1071		989,116	1,046,905			0	615,478	266,428		43%
kapitale + jashte buxhetore)		11,747,106	12,257,184	11,330,000	11,580,000	14,014,746	4,808,371	3,769,416	1,038,956	78%
Ndaj PBB ne %		0.62%	0.60%	0.52%	0.53%	0.64%	0.22%	0.17%	0.05%	
Shpenzimet Totale te konsoliduara		1.97%	1.90%	1.62%	1.66%	2.01%	0.69%	0.54%	0.15%	
Kosto mesatare /student ne lek		109,627	114,387	103,000	105,273	130,789	44,873	35,177		

Buxheti i rishikuar per vitin 2023, ne mijë lekë	
Pagat e punonjeseve	7,578,816,089 54%
Sqarime Shoqërore	1,203,787,692 9%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,507,064.0 25%
a- Subvencione	0.0 0%
B- Transfera Korente të Bex	315,000,000 2%
+ Transfera Korente të Huaj	12,462.41 0%
+ Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,291,298.5 9%
<b>Kapitale të Patrupezuara</b>	<b>15,915.92 0%</b>
Kapitale të Trupezuara	1,709,164.9 12%
	14,014,745.6 100%



### Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 4- mujorin 2023:

1. **Shpërndarja e fondeve për ndërkombëtarizimi e programeve të IAL publike**, parashikuar në shumën prej 300 milion lekë 2023-2024 parashikohet të realizohet pas datës 14 Maj 2023, **kufizimet ligjore të ligjit electoral**;
2. **Projekti i ri për ndërtimin e Kampusit Universitetit të Tiranës**, “Ndërtim Universiteti te Arteve”, si dhe “Ndërtimin e Akademisë së Policisë”, Tiranë, sipas VKM nr. 641 date 29.07.2020 fond granti nga Bashkia e Tiranës, janë në proces per realizimin e procedurave te parashikuara ne VKM për prokurimin publik në shumën prej 500 milion lekë.
3. **Universiteti Politeknik i Tiranës**, “Rikonstuksioni i Nderteses se Fakultetit te Gjeologjise dhe Minierave +Ndertimi i Muzeut te Gjeologjise\_UPT, ne proces se marrjes se lejes se ndertimit dhe procedures se prokurimit.
4. **Fondet e parashikuara për TVSH**, janë duke realizuar sipas shkallë së realizimit të disbursimeve të Financimeve te Huaja;
5. **Ndertimi i Godines se Re te Fakultetit te Shendetit Publik Universiteti "I. Qemali", VLORE, ne proces per marrjen e lejes se ndertimit nga Keshilli Kombetar i Territorit.**

### VI - Kërkimi Shkencor. (Titulli buxhetor i programit 09770);

Programi për Kërkimin Fundamental dhe Fondin e Ekselencës synon të mbeshtese kërkimin shkencor sipas prioriteteve kombëtare të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale në shërbim të IAL-ve e komunitetit shkencor. Në këtë kuadër kërkohet që puna kërkimore-shkencore të vihet në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit.

Synimi kryesor politik i programit është që sistemi i kërkimit shkencor t'i përgjigjet me besim të lartë sfidave të së ardhmes si çështjeve të mjedisit, mungesës së burimeve, çështjeve të shëndetit publik, të kohesionit social si dhe drejt zhvillimeve globale dhe integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Rritja e investimeve për SHTI bazuar në fondet publike dhe burime të tjera alternative deri në 1% të GDP. Programi synon zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në Shqipëri, për të arritur në raportin 7 kërkues për cdo 1000 të punësuar në vitin 2025.

Integrimi i kërkimit shkencor shqiptar në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA) numri i aplikimeve nga programet bilaterale dhe Programin Horizon Europe të rritet me me shumë se 10% në vit, duke orientuar kërkimin shkencor kah nevojave të tregut nëpërmjet forcimit të lidhjeve të Programeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare me biznesin privat.

**Objektivat kryesorë:**

**Objektiv 1).** Rritja dhe zgjerimi i kërkimit shkencor në Shqipëri bazuar në treguesit e OECD; ku pjesa e shpenzimeve publike në vitin 2025 të arrijë 1 % të GDP (e përlogaritur për IAL publike e private, ministritë e linjës, institucione të tjera kërkimore shtetërore, Akademia e Shkencave si dhe nga bizneset ).

**Objektiv 2).** Nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3500-3600 kërkuesve, **ku prioritet kanë kërkueset femrat**, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit.

**Objektiv 3).** Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve, në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, si dhe biznesin nëpërmjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL mbi Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare

**Objektiv 4).** Pjesëmarrja në programin Horizon, program për Kërkimin dhe Inovacionin (2021 - 2027). "Horizon Europe" do të bashkojë kërkimin me inovacionin dhe do të ketë një akses më të thjeshtë se programet paraardhëse për kompanitë dhe universitetet.

**Objektiv 5).** Promovim i Fondin e Ekselencës, rritjen efektivitetit të financimit, rikthimin e shpejtë të përfitimit të Shqipërisë, mbështetja financiare për 50 studentet në 15 universitetet me të mira të botës (Lista FT) dhe doktorantë ekselentë, si dhe ekselentë apo të punësuar në kuadër të programit "Brain Gain", prioritet rritjen me 10-20% të mbështetjes financiare për kërkueset vajzat studjueset femra, në përputhje me parimet e barazise gjinore. **VKM-në nr. 160, datë 19.02.2020** "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)" dhe **Udhëzimi nr. 6, datë 04.03.2020** "Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kritereve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë".

## **Fonde për "Kërkim dhe Ekselencë" (programi buxhetor 09770);**

**Fondet e miratuara për programin "Për Kërkim dhe Zhvillim" në buxhetin e miratuar për vitin 2023** ishin në masën 1 miliard e 31 milion lekë ose 0.05% ndaj PPB, si dhe 0.15% ndaj shpenzimeve publike. Fondet e rishikuara, së bashku me kursimet dhe të ardhurat e trashëguara për vitin 2022 arritën në **masën 1 miliard 138 milion lekë, ose afro 0.05% e PBB**, si dhe në masën 0.17% ndaj shpenzimeve publike realimi i fondeve në këtë program për vitin 2023 arriti në masën 107.4 milion lekë ose rreth 70% e fondeve të rishikuara për vitin 2023

- i. **Nxitja e punës kërkimore në IAL.** Mbështetje financiare për Programet Kombëtare të Kërkim-Zhvillimit në IAL dhe institutet shkencore (Veprimtaria e AKKSHI), shuma e parashikuar e fondeve është në masën 30 milion lekë, shuma e realizuar për këtë produkt për 4-mujorine parë 2023 është në masën 7.1 milion lekë ose 80% e fondeve të planifikuara për këtë periudhë.
- ii. **Financimi i Programe Kombëtare/Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik** të mbështetura financiarisht, shuma e parashikuar e fondeve është në masën 173.6 milion lekë, shuma e fondeve të rishikuara është në masën 156 milion lekë, fonde të realizuara për këtë produkt është në masën 5.8 milion lekë ose 80% e fondeve të planifikuara për këtë periudhë.
- iii. **"Financime grant per universitetet në bashkëpunim me bizneset"**, fonde për financimin e projekte kërkimore shkencore, financim në formë grant në shumën prej 82.2 milion lekë, fondi i rishikuara është në masën 121.6 milion lekë fonde grant me financim të brendshëm, realizimi për periudhën 4-mujore është në masë 9.5 milion lekë.
- iv. **Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër "Horizon Europe"**. Program i BE-së për Kërkim dhe Inovacion, pjesëmarrje e që premtion arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë së Europës në nivel global, për vitin 2023 janë parashikuar 100 milion lekë nga buxheti i shtetit si dhe 80 milion lekë nga të ardhurat, për pagesa kuota anëtarësie transferata ndërkombëtare shuma e parashikuar prej **180 milion lekë, nga të cilat shuma prej 100 milion lekë**, është planifikuar të paguhet me fonde grand nga buxheti si dhe **80 milion lekë nga rimbursimi i fondeve grand të BE**, për këtë marrëveshje. Pagesa për pjesëmarrjen në programin e Unionit Horizon Europe, është planifikuar për tu paguar brenda dates **15 Korrik 2023**.
- i. **Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër, ERASMUS+** "Marrëveshja midis Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrjen në Programin "Erasmus+ për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin", ratifikuar me Ligjin nr. 17/2014, datë 11.9.2014. është parashikuar kontributi financiar 90.000 (nëntëdhjetë mijë) Euro/vit, parashikuara për paguar me fonde grand nga buxheti, si dhe nga **rimbursimi i fondeve grand të BE. Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen në programin e nismës**

për reformën arsimore në vendet e Evropës Juglindore, **ERI SEE, pagesa e kuotës vjetore** “Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e nismës për reformën arsimore në vendet e Evropës Juglindore (ERI SEE)”, për vitin 2023, në **shumën prej 3.4 milion lekë, është paguar me fonde grand nga buxheti dhe nga të ardhurat.**

- ii. **Fonde të miratuara në formë grant, për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve ekselencë** që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitetet më të mira të botës; janë parashikuar **çdo vit 100 milion lekë. Për vitin 2023 deri tani janë realizuar vetëm 7.5 milion lekë nga 45.6 milion lekë të planifikuara për këtë kategori studentësh. Për vitin akademik 2023-2024 nuk janë shpallur procedurat për përzgjedhjen e studentëve.**
- iii. **Studentët ekselentë dhe ato që ndjekin programet prioritare, sipas kritereve të përcaktuara në** Vendimit nr.386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, për vitin 2023 janë miratuar 54.4 milion lekë, realizimi për periudhën është në **masën 25.2 milion leke.**
- iv. **Fonde për financimin e projekte kërkimore shkencore, zhvillimin e kapaciteteve akademike në shumën prej 550 milion lekë,** nga të cilat 250 milion fonde me financim të brendshëm si dhe 300 milion financim i huaj. Pas rishikimi këto fornde aritën në masën 550 milion lekë nga të cilat 250 milion fonde me financim të brendshëm si dhe 300 milion financim i huaj. Shtuar dhe të ardhurat këto fonde aritën në masën 556.1 milion lekë, realizimi ishte në masën 45.1 milion lekë ose në masën 50%.

Produkteve/ aktiviteteve të realizuara **nga Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në vitin 2023,** Ju bëjmë me dije si në vijim për veprimtaritë që lidhen me: **Integrimi evropian:**

**Marrëveshje dhe Memorandume të firmosura dhe në proces negocimi:**

14. Është firmosur më 13 janar 2023 “*Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin Reciprok ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës (Kampusit Bruzh)*”;
15. Është hartuar shtesa e protokollit me Austrinë për zgjatjen e protokollit deri në fund të vitit 2023, si dhe janë marrë komentete e ministrive të linjës mbi rinovimin e “*Protokollit të Mbledhjes IV të Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Austri për bashkëpunim në Fushat e Kulturës, Arsimit dhe Shkencës për vitet 2023-2027*” dhe është përcjellë drejt MEPJ;
16. Është negociuar mbi 2 (dy) marrëveshje ne fushën e arsimit me Kinën, për të cilat jemi në pritje të komenteve përfundimtare të Kinës;
17. Është negociuar me MEPJ dhe palën malazeze mbi “*Memorandumin e mirëkuptimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Rinisë dhe Fëmijëve të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Sporteve dhe Rinisë të Republikës së Malit të Zi në fushën e sporteve dhe rinisë*”, i cili u nënshkrua më 27 shkurt 2023, në Podgoricë gjatë G2G;
18. Është përgatitur dosja e plotë për ministren dhe është nënshkruar më 28 mars 2023 “*Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Ludëig-Maximilian të Mynihut për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në degën e studimeve të Albanologjisë*”;
19. Është përgatitur dosja e plotë për ministren dhe ministrinë e linjës dhe është nënshkruar më 16 mars 2023 “*Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunim në Fushën e Sportit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Sportit dhe Turizmit të Republikës së Polonisë*”;
20. Është përgatitur dosja e plotë për nënshkrimin e “*Protokollit të përbashkët për administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për projektin madhor në Albanologji “Enciklopedia shqiptare”*”, i cili u nënshkrua më 1 mars 2023;

21. Është negociuar dhe përgatitur dosja e plotë për ministren mbi “Memorandumin e Mirëkuptimi ndërmjet MAS dhe Kolegjit të Evropës për përfaqësim në Këshillin Administrativ”, i cili u firmos më 7 qershor 2023;
22. Është koordinuar nevoja për përkthim zyrtar me MD të marrëveshjeve me Kinën dhe CEEPUS IV, është kontraktuar një përkthuese zyrtare e MD;
23. Është konsultuar programi kulturor me Greqinë me MEPJ dhe është njoftuar UT;
24. Është përcjellë lista e marrëveshjeve ku përfshihet kërkimi shkencor dhe teknologjia, në kuadër të hartimit të kontributit të parë për Raportin e Komisionit 2023;
25. Në kuadër të mbledhjes së radhës të dy qeverive Shqipëri-Kosovë, të planifikuar të mbahet në muajin qershor 2023, DIKMA në koordinim me MEPJ, KM dhe palën kosovare ka hartuar 3 marrëveshje të reja, si dhe ka përfunduar të gjitha procedurat sipas ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në RSH”;
26. Më 14 prill 2023 është firmosur “Programi për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës”;
27. Në përbërje të grupit të punës që po negocion kontratën mbi termat e referencës të nënshkuara nga MAS, Bashkisë Durrës, Eagle Hills dhe MCFC.

**Koordinime për pjesëmarrje dhe takime bilaterale të Ministres, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Sektorit të Marrëveshjeve:**

1. Është realizuar takimi bilateral me ambasadorin rumun dhe është diskutuar për ecurinë e marrëveshjeve përkatëse në fushën e arsimit më 13 janar 2023;
2. Është realizuar takimi bilateral me ambasadorin turk dhe është përgatitur informacioni lidhur me këtë takim me 18 janar 2023;
3. Eshtë realizuar takimi me drejtorin e edukimit të Këshillit të Evropës dhe është diskutuar mbi disa çështje të fushës së arsimit si dhe mbështetjen e këshillit të Evropës për “konkursin e gjuhës amtare”, realizuar më 24 shkurt 2023;
4. Është realizuar takimi bilateral me ambasadorin bullgar dhe është diskutuar mbi mundësinë e një MM në fushën e sportit dhe mbi kurset e gjuhës bullgare dhe mundësitë e mësimit të gjuhës bullgare në sistemin arsimor parauniversitar realizuar më 12 prill 2023;
5. Është realizuar takimi bilateral me ambasadorin spanjoll ku u diskutua mbi mundësinë e futjes së gjuhës spanjolle në SAP dhe realizimin e provimeve ndërkombëtare DELE. Për këtë do të vijojë komunikimi me Institutin Servantes në Rome. Realizuar më 16.05.2023;
6. Është pritur delegacioni polak i kryesuar nga Ministri i Sporteve dhe Turizimit i Republikës së Polonisë Z. Kamil Bortniczuk, më 15 mars 2023, në orën 12:55 dhe kthimi më 16 mars 2023, në orën 12:15;
7. U mbajt takimi me ambasadoren e Francës lidhur me 5 problematika që kishin të bënin me ASA, seksionet dygjuhëshe, EFIT, dhe këshillin frankofon. Realizuar më 16.06.2023;
